

VNM PARAPRAKE- SHKOLLA 9 VJECARE “MARASH GJONI”

Rikonstruktion I godines ekzistuese, shtese anesore 3 kat dhe ndertimi i palestres ne shkollen 9-vjecare “Marash Gjoni ” Njesia administrative Rrile, Bashkia Lezhe
(Raporti i hartuar ne baze te shtojca II dhe VKM Nr. 686, date 29.07.2015, per VNM)



SIDITA KALACI

2024

Permbajtje

1.	INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR	2
1.1	Hyrje.....	2
1.2	Përshkrim te qellimit dhe objektivave te VNM-se	2
1.3	Përshkrim I Legjislacionit Në Fuqi:.....	3
2.	PERSHKRIMI I PROJEKTIT:	5
2.1	Vendodhja	5
2.2	Përshkrimi I Mbulesës Bimore Të Sipërfaqes Ku Propozohet Të Zbatohet Projekti.....	15
2.3	Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj	23
2.4	Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitetit, ujë, tokë dhe ajër.	26
2.5	Përshkrim i shkarkimeve të mundshme në mjedis (problemet mjedisore qe mund te lindin)	42
2.6	Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative	46
2.7	Shtrirja hapësinore e ndikimit negativ në mjedisin e zonës.....	49
2.8	Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të tij në gjendjen e mëparshme	51
2.9	Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis	54
2.10	Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)	62
3.	KONKLUSIONE DHE PERFUNDIME.....	62

Tabela e Figurave

Figure 1. Pozicioni me koordinata Gauss Kruger	6
Figure 2. Planvendosja e Propozuar	9
Figure 3. Planimetria e katit te per dhe	10
Figure 4. Planimetria e Katit te pare.....	11
Figure 5. Planimetria e katit te dyte	11
Figure 6. Planimetria e palestres se propozuar	12
Figure 7. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar	13
Figure 8. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar	14
Figure 9. Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar	14
Figure 10. Harta e qarkut Lezhe	15
Figure 11. Harta e zonave te mbrojtura.....	20
Figure 12. Rrjeti i zonave te mbrojtura.....	21
Figure 13. Lista e Zonave te Mbrojtura, Qarku Lezhe.....	22
Figure 14. Harta hidro-geologjike e zones	23
Figure 15. Harta e rrjetit hidrografik.....	24
Figure 16. Pozicioni i Objektit ne lidhje me burimet ujore	26
Figure 17. Vlerat mesatare të PM10 të monitoruara gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2021. (Burimi: AKM).....	28
Figure 18. Niveli i zhurmave për periudhën e ditës dhe natës, Lezhë. (Burimi: AKM).....	28
Figure 19. Fragment nga harta gjeologjike e zones.....	30
Figure 20. Tërmetet dhe preksshmëria në territor	31
Figure 21. Demografia e Qarkut Lezhe	32
Figure 22. Pozicioni i Parceles qe do te zhvillohet	34
Figure 23. Pozicioni ne lidhje me zonen urbane	34

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

1.1 Hyrje

Ky Vlerësim Paraprak i Ndikimit në Mjedis është i përgatitur për projektin "RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESE, SHTESE ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE "MARASH GJONI" NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE", me zhvillues BASHKINE LEZHE dhe është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar për këtë projekt.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM përdoren informacione dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, se bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të faciliteteve të propozuara. Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së. Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- o Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- o Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- o Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- o Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- o Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- o Parimi i qasjes së integruar
- o Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- o Parimi "Ndotesi paguan"
- o Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- o Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

1.2 Pershkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-se

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.

4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

1. Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
11. Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendndodhjes së projektit.
12. Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për të aplikuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- o Siguron dhe mbron shëndetin e njeriut;
- o Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme të mjedisit;
- o Permireson aspektet sociale-ekonomike të projektit;
- o Ndhmon në realizimin e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të mjedisit;

Pershkrim i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- o Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- o Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kryhet aktiviteti;
- o Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- o Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- o Historiku i ndërveprimit mjedisor;

1.3Përshkrim I Legjislacionit Në Fuqi:

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 'Për mbrojtjen e mjedisit', të ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 'Për vlerësimin e ndikimit në mjedis', të ndryshuar;

3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 "Per mbrojtjen e faunes se eger"
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura" ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 "Per zonat e mbrojtura"
5. Ligi nr.10 253, date 11.3.2010 "Per gjuetine"
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
9. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
11. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullosor te ndryshuar"
12. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
13. Ligji nr. 68/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, "Per mbrojtjen e biodiversitetit", te ndryshuar.
14. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
15. VKM nr. 686, date 29.07.2015 'Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore';
16. VKM nr. 247, date 30.04.2014 "Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore"
17. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011"Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", te ndryshuar;
18. VKM nr. 575 date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte"
19. VKM nr.175, date 19.1.2011 "Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve"
20. VKM nr. 371, date 11.06.2014 "Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme"
21. VKM nr. 418, date 25.06.2014 "Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve neburim"
22. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 "Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme"
23. VKM nr.519, date 30.6.2010 "Parqet Natyror Rajonal"
24. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kritereve te administrimit te pyllit komunal"
25. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor"
26. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
27. VKM nr.897. date 21.2.2011 "Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave teVecanta te Ruajtjes"
28. VKM nr. 532, date 05.10.2000 "Per miratimin e studimit "Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin"

29. VKM nr. 676, date 20.12.2002 "Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare"
30. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
31. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 "Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise"
32. VKM nr 352, date 29.04.2015. "Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te".

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBETAR

- o Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqasë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :
- o Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- o Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit ne fushën e politikës së ujrave.
- o Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- o Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- o Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- o Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- o Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.
- o Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- o Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- o Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- o Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla
- o Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT:

2.1 Vendodhja

Objekti: "RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESE, SHTESE ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE "MARASH GJONI" NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE"

Vendodhja: Bashkia Lezhe

Kategoria e Lejes: VNM Paraprake

- Koordinatat Gauss Kruger

Nr.	E	N
Pika 1	4387278.34	4621806.32
Pika 2	4387335.84	4621794.64
Pika 3	4387317.43	4621721.79
Pika 4	4387262.10	4621743.62



Figure 1. Pozicioni me koordinata Gauss Kruger

- Foto te sheshit ekzistues:



Foto 1



Foto 2



Foto 3



Foto 4

Planvendosja e propozuar



Figure 2. Planvendosja e Propozuar

- Shkolla

Rikonstruksioni I godines ekzistuese nepermjet perforcimit te mureve mbajttese si edhe te soletave ekzistuese, shtesa anesore 3 kate ne anen jugore te godines, si edhe riorganizimi I ambienteve te brendshme si me poshte:

Kati perdhe siperfaqe totale prej 870.5m² me ambientet si me poshte:

- 4 Klasa per ciklin e shkolles me siperfaqe mesatare reth 37.5m² dhe kapacitet maksimal prej 30 nxenes.

- 2 NHS per mesuesit, NHS per femijet vajza dhe djem te ndare me nga 6 vende/secilin, si edhe 1 NHS per personat me aftesi te kufizuar
- 1 Laborator Fizike/Kimie
- Dhome infermierie
- Kopeshti me 3 klase me nje kapacitet prej 30 femije/klase, i cili eshte konceptuar me hyrje me vete si edhe i ndare nga shkolla. Gjithashtu eshte menduar te lihet nje menyre komunikimi me shkollen nepermjet deres.
- Ambienti i kuzhines per kopeshtin
- NHS per femijet e kopshtit si edhe per edukatoret
- Ambienti per stafin e kopshtit me nje siperfaqe prej 36.6m².

Per Hyrjen ne shkollë eshte parashikuar edhe ndertimi i rampave per personat me aftesi te kufizuar. Ne pjesen e jashtme te godines, eshte parashikuar edhe ambienti teknik per pajisjet, e cila nuk ka komunikim me ambientet e brendshme te shkolles. Ndersa ne pjesen fundore te korridorit eshte parashikuar edhe vendosja e ashensorit per lezjen e stafit ose edhe te personave me aftesi te kufizuar.




Figure 3. Planimetria e katit te perdhe

Kati i Pare me nje siperfaqe totale prej 801.5m² me ambientet si me poshte:

- 10 klase per ciklin e shkolles 9 vjecare
- 2 NHS per vajza dhe djem te ndara me nga 6 vende secila
- 2 NHS per stafin
- 1 NHS per personat me aftesi te kufizuar
- Drejtoria
- Sekretaria

- Dhoma e psikologut



Figure 4. Planimetria e Katit te pare

Kati i Dyte me nje siperfaqe totale prej 801.5m² me ambientet si me poshte:

- 8 klasa per ciklin e shkolles 9 vjecare
- 2 NHS per vajza dhe djem te ndara me nga 6 vende secila
- 2 NHS per stafin
- 1 NHS per personat me aftesi te kufizuar
- Ambient ndihmes/magazine
- Biblioteka
- Keshilli Pedagogjik/Dhoma e mesuesave
- Klasa e Investuar nga fondi amerikan (do ruhet sipas gjendjes ekzistuese pasi nuk nderhyhet dot).




Figure 5. Planimetria e katit te dyte

- Palestra

Gjithashtu ne kete projekt eshte propozuar edhe ndertimi i palstres se re te mbyllur, godine kjo e konceptuar vecmas godines ekzistuese te shkolles, me nje siperfaqe totale te gjurmes prej 403.2m². Ne kete godine jane parashikuar te behen edhe dhomat e zhveshjes si edhe NHS.




Figure 6. Planimetria e palestres se propozuar

- Pozicionimi ne parcele

Përsa i përket pozicionimit të godinës në parcelë mund të themi se ajo eshte vendosur ne menyre te tille qe fasadat kryesore jane te orientuara lindje /perendim dhe hyrja kryesore duke qene lehtesisht e arritshme nga femijet dhe punonjesit.

Pozicionimi i hyrjes ne pjesen ballore te godines e ben ate jo vetem lehtesisht te aksesueshem nga frekuentuesit, por sherben edhe si nje element formues ne pamjen e objektit.

- Konceptimi arkitektonik

Qëllimi kryesor i projektit nga pikëpamja arkitektonike është që të krijojë një ambjent edukativ që plotëson në mënyrë të plotë termat e referencës, një ambjent që të jetë funksional dhe me hapësira

të menaxhueshme, të ketë një shkallë sa më humane perceptimi si dhe të krijojë një ambient mikprites për të gjithë. Projekti synon gjithashtu të prezantojë një experiencë të re projektimi të shkollave duke përmirësuar standardet sociale të tyre, si dhe të shërbejë si një pikë sociale për komunitetin.

Godina në total ofron ambiente me funksionet e nevojshme për një fëmijë të kopshtit dhe shkolles të ditëve të sotme. Ajo sjell ambiente mësimdhënie, edukative, ambiente lojrash dhe një sërë shërbimesh të tjera.

Projekti parashikon një mbrojtje të mirë kundër zjarrit si në aspektin e specifikimeve të materialeve të përdorura ashtu edhe në aspektin e evakuimit dhe masave që përdoren për fikjen e zjarrit.

Nga ana arkitektonike projekti është trajtuar me një gjuhë bashkëkohore ekspresive. Materialet e përdorura për fasadat, në aspektin e rifiniturave, veshjeve dhe ngjyrave, të sistemeve të jashtme, është përdorur teknologji ndërtimi bashkëkohore, por dhe e pershtatshme për zonën lokale ku po ndërtohet. Projekti trajton me hollësi të gjitha detajet e sistemit të jashtëm.

Për fasadat është përdorur sistemi i veshjes me kapote dhe suvatim me grafiato me ngjyrë. Në ambientin e jashtëm do të krijohet një zonë rekreacioni me gjelberim dhe me lojra për arëtimin e fëmijëve.

Ambjentet do të pajisen me sistem ngrohjeje. Të gjitha dritaret janë parashikuar me dopio xham për efekt termoizolimi.



Figure 7. Pamje 3D të shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar



Figure 8.Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar



Figure 9.Pamje 3D te shkolles Marash Gjoni, Projekti i propozuar

2.2 Përshkrimi I Mbulesës Bimore Të Sipërfaqes Ku Propozohet Të Zbatohet Projekti

Biodiversiteti përbën një komponent shumë të rëndësishëm të pasurive natyrore të një vendi, hapësirë apo rajoni. Me biodiversitet nënkuptohet shumëllojshmëria e organizmave të gjalla në të gjitha nivelet, duke përfshirë ato tokësore, detare, ujërave të ëmbla, si dhe komplekse ekologjike, pjesë e të cilëve ato janë. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktorë gjeologjikë, pedologjikë, hidrologjikë, relievi dhe klima.

Qarku i Lezhës është një nga 12 qarqet në Shqipëri dhe ka një sipërfaqje prej 1.588 km². Qarku i Lezhës i përfshin rrethin e Kurbinit, rrethin e Lezhës dhe rrethin e Mirditës. Qendra e Qarkut të Lezhës ndodhet në qytetin e Lezhës. Qarku i Lezhës kufizohet në veri me Qarkun e Shkodrës, në verilindje me Qarkun e Kukësit, në lindje me Qarkun e Dibrës, në jug me Qarkun e Durrësit dhe në perëndim me Detin Adriatik. Qarku i Lezhës ka një popullsi prej 158.377 banorë. Historia e këtij rajoni është e hershme, mbi 2000-vjet përpara lindjes së Krishtit.



Figure 10. Harta e qarkut Lezhë

3837m², ku ka një gjelbërim të kultivuar me shkurre të ndryshme, pemë, etj.

Projekti: “RIKONSTRUKSION I GODINËS EKZISTUESE, SHITESHES ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE “MARASH GJONI” NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE” do të zhvillohet në territorin e njësise administrative Shënkoll, Bashkia Lezhë. Sheshi I përcaktuar për ndërtim është I orientuar lindje-perëndim sipas brinjës më të madhe, sipërfaqja e gjurmës së ndërtësës është 560m², me trek ate dhe një lartësi totale të godinës prej 11.10m. zona ku do të bëhen punimet do të jetë brenda sheshit të rehabilituar të godinës ekzistuese të shkollës, me një sipërfaqe trualli



Foto 5



Foto 6

- *Informacion rreth bimesise (Flora dhe Fauna) dhe zonave te mbrojtura te rajonit*

Flora

Lezha shtrihet ne pjesen perendimore te Shqiperise, ne jug te fushes se Shkodres. Nga ana gjeografike ze nje vend te favorshem ne rruget qe lidhin perendimin me lindjen e rajoneve

shqipfolese. Ne nje largesi prej 300 km eshte nje lidhese e Prishtines me rajonet jugore te Shqiperise. Ajo ka pozite gjeografike te favorshme, me nje siperfaqe prej 473 km², tregues ky qe e rendit Lezhen nder rrethet e vogla te Shqiperise, me nje vije kufitare prej 181 km, nga e cila 124 km kufi tokesor, 27.5 km kufi detar dhe 29.5 km kufi lumor. Gjatesia me e madhe e rrethit te Lezhes, nga veriu ne jug, eshte 30 km dhe nga perendimi ne lindje 27 km.

Relievi i Lezhes paraqitet ne dy pamje: Krahina Malore Qendrore, ku futen zonat Kashnjet, Kreshte, Mali i Veles, Malesia e Lezhes, deri ne jug, Kodrat e Pllanes dhe Ultesira Perendimore, ku perfshihet gjithë pjesa tjeter, fusha dhe tokat e lagura (pothuaj ne raporte te barabarta). Ndryshe nga relievi i vendit, ai i Lezhes paraqet nje pamje me siperfaqe nen nivelin e detit (Kenetat Knalle e Kakarriq), fusha me lartesi 0 – 10 m mbi nivelin e detit dhe male me lartesi mbi 1000 m. Ky relief, prania ne te e zonave te lageta (ligatinave), fushave e malit, tokave te pasura dhe klimes mesdhetare, ka kushtezuar vegjetimin e nje flore te pasur pyjore, qe me shifra mund te shprehet: afro 80 % e specieve te vendit (3250 specie). Speciet e drureve pyjore jane te perhapura ne formen e shoqerimeve pyjore. Pervec specieve qe rriten rastesisht (spontanisht), nepermjet pyllezimeve jane instaluar lloje me rritje te shpejte, si Pisha e detit (*Pinus pinaster*), Pisha e bute (*Pinus pinea*), Pisha e eger (*Pinus halepensis*) etj.

Fondi pyjor i Lezhes ze 38 % te siperfaqes totale. Nga ky kendveshtrim, siperfaqja me pyje eshte e vogel e, per rrjedhoje, ndikimi ne ekonomi eshte i tille. Por, duhet vecuar sistemi lagunor Kune – Vain, si pasuri e rralle e me vlera te medha.

Sipas funksionit qe kryejne, pyjet e ketij rrethi grupohen:

- * Pyje me funksion prodhues 10860 ha ose 60 % e siperfaqes, ku perfshihen pyjet me destinacion kryesor prodhimet drunore.

- * Pyje me funksion mbrojtës 7280 ha ose 40 % e siperfaqes, ku futen pyjet qe si funksion kryesor kane mbrojtjen e mjedisit.

Sipas formes se qeverisjes, fondi pyjor (shteteror + komunal) i Lezhes ndahet:

- * Trungishte 5530 ha,

- * Cungishte 5510 ha

- * Shkurre 7030 ha.

Ne 16 % te siperfaqes jane instaluar pyje halore, kryesisht pyllezime me pishe te zeze, pishe bregdetare etj. Fletorët zene 45.6 % dhe shkurret 38.4 %. Ne siperfaqen e pyjeve fletore peshen kryesore e zene dushqet (*Quercus L.*), ndersa ne ate me shkurre peshen kryesore e zene mareja (*Arbutus uneda*), shkoza (*Carpinus L.*) etj.

Territori kufizohet nga lumi drin ne veri- perendim dhe lumi Mat ne jug- lindje, ne pjesen jug-perendimore kufizohet me detin Adriatik. Kjo vecori e relievit dhe vendosja gjeografike ne kryqezimin e klimes mesdhetare me ate kontinentale e ben kete hapsire nje dukuri krahasimisht te vecante per te poseduar nje larmi ekologjike. Mjafton te themi se ne hapsiren e rrethit te Lezhes gjenden mbi 70 % e llojeve te bimeve qe gjenden ne vendin tone. Sot kultivohen 120 lloje bimesh

e shume nga keto 2-3 here ne vit. Bujqesia e rrethit te Lezhes mbizoteroheT nga dritherart, frutikultura, etj. Ne zonen e Lezhes mbillet gruri, meli, bostani, qepa, hudhra, fasulja: ne zonën kodrinore malore me shume mbillet elbi dhe tershera. Misri deshmoheT i mbjelle ne zonen e Zadrimes.

Fauna

Studimi dhe ruajtja e faunës është një nga elementet kryesore të biocenozes pyjore, i lidhur shume ngushte me ruajtjen e biotopit të saj. Per këtë arsye cdo nderhyrje e pakualifikuar mund të krijoje pasoja shume të rënda tek fauna dhe tek vlerat e biodiversitetit. Bregu jugor Shqiptar ka po ashtu edhe një shumëllojshmëri e pasur faune ku ndër më kryesorët dallojmë:

Shpendët: një shumëllojshmëri shpendësh dallohen në qarkun e Lezhës (rreth 203 lloje). Për shumëllojshmërinë e shpendëve, zona është quajtur "Oaz i ornitologjisë së Mesdheut" ku popullojnë më shumë çafkat, karabullakët, rosat, baltaket, pulëbardhat etj. Shumë lloje faunistike botërisht të rrezikuara, kanë një pjesë të arealit në këtë ekosistem. Shpendët grabitqarë gjithashtu dallohen kryesisht në zonën e malit të Rrencit.

Zvarranikët: edhe zvarranikët janë dalluar kryesisht në malin e Rrencit.

Gjitarët: dallohen si më të pranishëm gjitarët e mëdhenj si: dhelpra, lepuri, ujku, kunadhja, por në areale më të larta si Vinjolli vrojtohen dhe kaprolli e ariu.

Zonat e Mbrojtura

"Zonë e mbrojtur" është një hapësirë tokësore, ujore, detare e bregdetare, e përcaktuar qartë gjeografikisht, e njohur, me kufij të qartë fizikë dhe e menaxhuar përmes mjeteve ligjore apo mjeteve të tjera të efektshme, për të arritur ruajtjen/mbrojtjen afatgjatë të natyrës, e lidhur me shërbimet e ekosistemit dhe të vlerave kulturore. Zonat e mbrojtura mjedisore, sipas llojit të interesit për të cilin ka marrë statusin e mbrojtjes, janë:

- a) zona të mbrojtura me interes kombëtar;
- b) zona të mbrojtura me interes ndërkombëtar ku bëjnë pjesë:
 - (i) zonat "Ramsar";
 - (ii) zonat me interes për Komunitetin Europian (SACs), (SCI dhe SPAs);
 - (iii) zonat me interes të veçantë ruajtjeje (zonat e rrjetit Emerald);
 - (iv) zonat "Rezervë të biosferës"; dhe
 - (v) zonat e trashëgimisë natyrore.

Rrethi Lezhë

1. Rëra e Hedhur
2. Rrapi i Grykës
3. Rrepet e Kolshit
4. Shpella e Hutit
5. Shpella e Sukës së Vogël
6. Dritarja tektonike e Mirditës
7. Rivat e Drinit
8. Këneta e Kashtës

9. Rivat e Drinit
10. Rrapi i Pirajave (Blinisht)
11. Lisi i Markatomajt
12. Pylli (dushk, frashër, shkozë)i Shënmërisë Kallmet (ha)

Rrethi Mirditë

1. Kanioni i Shehut të Keq
2. Shpella Kusia e Nue Gjonit
3. Rrobulli i Blaçit
4. Guri i Gjonit
5. Guri i Nuses
6. Kroi i Bardhë
7. Mrizi i Shënaprenës
8. Rrapi i Kaçinarit
9. Lisat e Shpalit
10. Lisat e Marpepës

Rrethi Kurbin

1. Tarraca Detare e Laçit
2. Gryka e Shkopetit
3. Frashëri - Kurbin
4. Lisat e Shënmillit
5. Plepi i Bardhë
6. Shpella e Shënavlashit (Shënnadoi)
7. Gështenja e Vjetër
8. Rrapi i Daulles
9. Burimi i Vinjollit
10. Ishulli i Cabakut
11. Kordoni litoral i Bregut të Ri
12. Selvitë e Shënmërisë

Zona e projektit nuk është e përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë në asnjërën nga kategoritë e zonave të mbrojtura në Shqipëri sipas kategorizimit të IUCN, sikurse shihet në "Hartën e Zonave të Mbrojtura të Lezhës". Territori në studim ku do realizohet projekti nuk shërben as edhe si zone buferike, të cilat ruhen nëpërputhje me legjislacionin e Mjedisit në fuqi dhe në përputhje me politikat dhe planet që aplikon Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Zona në studim nuk bën pjesë as edhe në zonat e mbrojtura me interes të vecantë që mbrohen nga konventat nderkombëtare, si: Konventa mbi ligatinat me rëndësi ndërkombëtare veçanërisht si habitate të shpendëve ujore (konventa e Ramsarit); Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Europës (Konventa e Bernës); Konventa botërore e trashëgimise, etj.




Figure 11. Harta e zonave te mbrojtura

- Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshi edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona në vlerësim nuk vlerësohet si zone me status të veçantë nga MM. Sic shihet edhe në hartën e mëposhtme, zona në vlerësim përmban zonat e mbrojtura si më poshtë:




Figure 12. Rrjeti i zonave të mbrojtura

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)

- Lista e zonave të Mbrojtura të Trashegimise në Qarkun Lezhë

LISTA E ZONAVE TË MBROJTURA - QARKU LEZHË 2018								
NR.	EMËRTIMI I ZONËS		ADRESA					TË DHËNA TË SHPALLJES
			LAGJJA	FSHATI	NJËSIA ADMIN.	BASHKIA	QARKU	INSTITUCIONI/ NR. VENDIMIT/ DATA
1	ZONA ARKEOLOGJIKE 'A' DHE 'B' E QYTETIT LEZHË DHE RREGULLORJA ADMINISTRIMIT				Lezhë	Lezhë	Lezhë	Këshilli I Ministrave/ nr.728/ dt.01.09.2010
2	1.KUFIJTE DHE RREGULLORJA E ADMINISTRIMIT TË PARKUT ARKEOLOGJIK LEZHË; 2.PER DISA NDRYSHIME NE VENDIMIN NR. 396, DT. 31.03.2005, TE KESHILLIT TE MINISTRAVE "PER MIRATIMIN E KUFJEVE DHE RREGULLORES SE ADMINISTRIMIT TE PARQEVË ARKEOLOGJIKE TE SHKODRES, LEZHES, APOLONISË, BYLISIT, AMANTIAS, ORIKUMIT, ANTIGONESE, FINIQIT DHE BUTRINTIT", TE NDRYSHUAR DHE VKM 163 DT. 27.02.2013				Lezhë	Lezhë	Lezhë	1.Këshilli I Ministrave / nr.396/ dt.31.03.2005; 2. Vendim I Keshillit të Ministrave / nr.249/ dt.30.04.2014
3	ZONA E MBROJTUR "RRËNOJAT E MALIT TE SHELBUJEMIT (AKROLISI)" ME NJË DISTANCË PREJ 20 M RRETH E QARK MUREVE				Lezhë	Lezhë	Lezhë	Vendim i Institutit i Shkencave (botuar në Gazetën Zyrtare Nr. 95, dt. 16.10.1948)
4	ZONA E MBROJTUR E KISHËS SË SHËN VENERANDES			Pllanë	Zejmen	Lezhë	Lezhë	Ministria e Kulturës/ nr.107/ dt.19.03.2015
5	ZONA E MBROJTUR E KISHËS SË SHËN E PREMTES			Ballëdren	Ballëdren	Lezhë	Lezhë	Ministria e Kulturës/ nr.105/ dt.19.03.2015
6	ZONA E MBROJTUR E BURGUT TË SPAÇIT			Reps	Orosh	Mirditë	Lezhë	Ministria e Kulturës/ nr.241/ dt.23.06.2015
7	ZONA E MBROJTUR E PIKTOGRAMEVE NË SHITREHEN SHKEMBORE DHE KALASË SE RUBIKUT				Rubik	Mirditë	Lezhë	Ministria e Kulturës/ nr.366/ dt.09.10.2015
8	ZONA E MBROJTUR E KISHËS SË MANASTIRIT TË RUBIKUT				Rubik	Mirditë	Lezhë	Ministria e Kulturës/ nr.367/ dt.09.10.2015

Figure 13.Lista e Zonave të Mbrojtura, Qarku Lezhë

- Klima

Zona e Lezhës karakterizohet nga një klimë e butë e tipit mesdhetar për shkak të pozitës gjeografike me dalje të gjerë në det dhe me reliev në përgjithësi të ulët. Rrethi i Lezhës karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë, dimër i butë dhe i lagësht në pjesën e ulët dhe qytet, ndërsa dimër të lagësht dhe të ftohtë në zonën malore. Temperatura mesatare vjetore për rrethin është 15 gradë, mesatarja e Janarit 7 gradë, ndërsa mesatarja e Korrikut plus 24-25 gradë. Në këtë zonë bien mesatarisht 1700 mm reshje në vit.

Këto karakteristika klimatike janë të përshtatshme për qëllime në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit. Kështu, punimet e ndërtimit mund të realizohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Megjithatë është sugjeruar për të shmangur periudhat kur bie shi në punimet në mjedise të hapura e sidomos në lartësi.

2.3 Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të saj

- Hidrogeologjia

Nga pikpamia hidro-gjeologjike niveli i ujit ne punimet fushore u takua ne grop-sonden e kryer ne:

Grop-Sonda	Takimi
G-S. Nr.1	-0.8 ml nga niveli i tokes natyrale



Figure 14. Harta hidro-gjeologjike e zones



- Rrjeti Hidrografik

Figure 15. Harta e rrjetit hidrografik

Lezha me zonat përreth është një ndër rajonet e Shqipërisë më të pasura me ujra. Kjo pasuri ujore e saj përbëhet kryesisht nga ujrato e detit Adriatik që lagin brigjet e këtyre zonave, ato të rrjetit hidrografik, ujrato e lagunave në të dy anët e grykëderdhjes në det të lumit Drin i Lezhës dhe ujrato nëntokësore të fushës së Lezhës. Rrjedhjet ujore më të rëndësishme që formojnë këtë rrjet hidrografik janë lumi Drin i Lezhës dhe lumi Gjadër. Lumi Drin ka qenë elementi kryesor i sistemit dhe i rrjetit hidrografik të Lezhës dhe i zonave përreth. Vetë ky sistem hidrografik në një shkallë të konsiderueshme është rrjedhojë e veprimtrisë dhe e prurjeve të lëngëta e të ngurta që lumi Drin ka përcjellë në shekuj në detin Adriatik. Por sot, ky lumë nuk kalon më në shtratin e tij shekullor, përbri qytetit të Lezhës. Ai nuk i derdh më ujrato e tij në det, por në lumin Buna. Lumi Drin është lumi më i madh i Shqipërisë dhe i dyti

përsa i përket ujshmërisë, mbas lumit Buna. Ai është lumi më i madh në tërë bregdetin Adriatik të gadishullit Ballkanik. Sipërfaqja e pellgut e tij ujëmbledhës është 14173 km², prej të cilave 5978 km² ndodhen brenda territorit shtetëror të Republikës së Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër ndodhet në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në atë të Greqisë. Prurja mesatare vjetore që lumi Drin derdh në lumin Buna është rreth 340 m³/sek. Lumi Drin formohet nga dy degë kryesore : Drini i Zi dhe Drini i Bardhë. Nga fillimi i tij në liqenin e Ohrit (Strugë) deri në derdhjen në lumin Buna, ka gjatësinë 285 km dhe një rënie prej 685 m, me një pjerrësi mesatare prej 2,4 për mijë. Lumi Drin përbën burimin më të madh hidroenergjitik të Shqipërisë.

Lumi Gjadër është degë e lumit Drin. Ka më shumë karakteristikat e një lumi torencial. Sipërfaqja e pellgut të tij ujëmbledhës është 199 m². Karakterizohet nga një reliev malor, me lartësi mesatare 422 m mbi nivelin e detit. Sasia mesatare vjetore e rreshjeve që bien në këtë pellg ujëmbledhës është rreth 1900 milimetra në vit. Prurja mesatare vjetore që ky lumë derdh në lumin Drin është 8,80 m³/sek.

Gjiu i Drinit shtrihet ndërmjet grykëderdhjes së Bunës në Veri dhe Kepit të Rodonit në Jug. Ka gjatësi maksimale rreth 30 km dhe gjerësi rreth 20 km. Është një gji relativisht më i thellë se gjiret e tjerë shqiptarë të Adriatikut. Izobati 10 m ndodhet 600 deri 1500 m larg vijës së bregut.

Lagunat, element përbërës dhe shumë i rëndësishëm i sistemit hidrografik të Lezhës janë dhe lagunat. Në grykëderdhjen e lumit Drin të Lezhës, në anën e djathtë të rrjedhjes, ndodhet laguna e Kënallës, më e thella nga lagunat shqiptare buzë detit Adritik, me sipërfaqe 0,201 km² dhe thellësi maksimale 13-14 m. Më në jug, po gjatë bregut të djathtë të Drinit ndodhet laguna e Merxhanit, me sipërfaqe rreth 3 km² dhe thellësi mesatare 0,75 m. Thellësia maksimale e saj është 1,30 m. Në bregun e majtë të grykëderdhjes ndodhet laguna e Vainit, me sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 9 km² dhe thellësi mesatare 0,70 m.

- *Ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore*

Fushat e Lezhës përbëjnë sektorin më verior të Pellgut të madh të ujrave arteziane që shtrihet nga Tirana në drejtim të lumit Ishëm. Shtresat më të përshkueshme të depozitimeve aluviale që formojnë këtë fushë janë shtresa zhavorore dhe zhavororo-ranore. Ato ngopen me ujra të freskëta, që krijojnë një horizont ujëmbajtës artesian shumë shtresor. Rezervat natyrore të ujrave nëntokësore të fushës së Lezhës vlerësohen në rreth 2500 litra në sek. Në këtë fushë janë shpuar shumë puse për shfrytëzimin e ujrave nëntokësore që ajo ka. Këta puse japin me vetërrjedhje një prurje nga 10-20 l/sek deri në 50-60 l/sek. Tre prej tyre furnizojnë qytetin e Lezhës me ujë të pijshëm. Puse të tillë në këtë zonë përdoren edhe për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore në fushën e Rrillës. Të tjerë janë shpuar në periferitë e lagunave, ujrata e të cilëve përdorne kryesisht për t'i përzierë me ujrata e kripura, për uljen e kripshmërisë sidomos gjatë periduhës së verës, kur avullimi në laguna është shumë i madh.

- *Çeshtje Mjedisore që lidhen me ujin e pijshëm*

Ka raste kur cilesia e ujit kompromentohet kryesisht nga ndotjet që peson në linjat e transmetimit (ndotja nga ujrata e zeza, për shkak të intersektimeve të shumta të tubacioneve të ujit të pishem me ato të ujrave të zeza).

Përdorimi për qëllime të tjera vec përdorimit familjar, është i madh duke ulur sasitë e nevojshme për popullsinë. Burimet ujore nëntokësore, sidomos ato deri në 20 m thellësi janë të rrezikuara nga ndotja sipërfaqësore për shkak të përshkueshmerisë së lartë të shtresave mbrojtëse.



Figure 16. Pozicioni i Objektit në lidhje me burimet ujore

2.4 Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitetin, ujë, tokë dhe ajër.

2.4.1 Informacione mbi elementet e mjedisit

- Cilesia e Ajrit

Ndotja e ajrit përbën një problem të rëndësishëm mjedisor dhe social, efektet e të cilit shfaqen në shëndetin e njerëzve, ekosistem dhe klimë. Ndotësit kryesor të ajrit emëtohen nga aktivitete antropogjene dhe natyrore, kanë veti të transportohen në distanca të gjata dhe të prekin sipërfaqe të mëdha. Disa prej tyre mund të qëndrojnë në ambjent për një kohë të gjatë dhe të akumulohen në mjedis, të shfaqen në zinxhirin ushqimor duke ndikuar në jetën e njerëzve dhe kafshëve jo vetëm përmes ajrit por dhe ujit e ushqimit. Transporti, industria, agrikultura, menaxhimi i mbetjeve, të gjitha kontribuojnë në shfaqjen e këtij efekti. Ndotësit më të rëndësishëm të ajrit janë: NO_x, SO_x, NH₃, CO, CO₂, VOC, PM₁₀, PM_{2,5}, benzo(a) pireni BaP.

PM₁₀ - Grimcat e ngurta gjenerohen nga të dy burimet, ai antropogjen dhe natyror. Burimet natyrore përfshijnë kripën e detit, pluhurin e përhapur në mënyrë natyrore, polenet, hiri vullkanik. Shpërhapja e grimcave të ngurta nga efekti antropogjen haset kryesisht në zonat urbane dhe shkaktohet nga djegja e karburantit për prodhimin e nergjisë, proceset e ndryshme djegies, etj.

O₃ - Ozoni nuk emetohet drejtpërdrejtë në atmosferë. Ai krijohet si rezultat i një sërë reaksioneve komplekse midis gazeve si NO_x dhe NMVOC-ve (komponime organike jo volatile pa përmbajtje

metani). Gazet CH₄ dhe CO luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e nivelit të O₃ në atmosferë.

NO_x - Burimet kryesore të emëtimit të oksideve të azotit në atmosferë janë proceset e djegjeve të karburantit të përdorur në automjete dhe funksionimi i termocentraleve. Eksperimentet kanë treguar se NO₂ është 4 herë më vdekjeprues se NO. Për këtë arsye edhe janë vendosur standardet e lejuara për NO₂ dhe rezultatet e matjeve në cilësinë e ajrit i referohen koncentrimin të NO₂. Dioksidi i Azotit (NO₂) sikur dhe Dioksidi i Squfurit (SO₂) janë pjesë përbërëse e smogut dhe shkaktarë të shirave acidike.

Benzo(a)pireni (BaP)- krijohet nga djegia jo e plotë e disa lëndëve djegëse. Burimi kryesor i emëtimit të këtyre komponimeve sot në Europë janë djegia e drurit dhe qymyrit, incenerimi i mbetjeve, industria prodhuese e celikut dhe koksit, trafiku rrugor, riveshja e gomave, zjarret natyrore etj.

SO_x-Oksidet e squfurit janë një familje gazesh që përfshijnë SO₂ dhe SO₃. Emëtohen në atmosferë nga djegia e karburantit me përmbajtje squfuri. Shkaktojnë kryesore antropogjenike të emëtimit të SO₂ në atmosferë janë ngrohjet shtëpiake, transporti, prodhimi energjisë. Vullkanet janë burimi kryesor natyror i emëtimit të SO_x.

CO dhe C₆H₆ -Monoksidi i karbonit dhe benzeni janë gaze të emetuara nga djegia jo e plotë e lëndëve djegëse fosile dhe biokarburanteve. C₆H₆ shërben si një aditiv i shtuar tek benzina, si rrjedhojë sasia më e madhe e emetuar vjen nga trafiku rrugor.

CH₄ -Gazi metan është një prekursor i ozonit O₃, i cili ka një efekt mjaft të rëndësishëm në ngrohjen globale. Emëtohet nga industria e prodhimit të energjisë, menaxhimi i mbetjeve dhe agrikultura.

CO -Monoksidi i karbonit është në përqëndrime të larta në zonat urbane kryesisht gjatë orëve me trafik të rënduar dhe nga industrinë e rënda.

Zhvillimet e vrullshme urbane dhe industriale të cilat kanë prekur dhe Shqipërinë, kanë bërë që dhe vëndi ynë të ndikohet nga prezenca e këtyre ndotësve.

Konkluzione

Nga rezultatet e monitorimit vërehet se shkarkimet për të dyja gazet NO_x dhe O₃ janë brënda normave të lejuara sipas legjislacionit Shqiptar dhe atij Europian. Kontribut më të madh në vlerat e ozonit ka dhe rrezatimi diellor, duhet theksuar se në ditët e monitorimit koha ka qene e kthjellët dhe me rrezatim diellor gjatë gjithë ditës. Kryesisht përqëndrimet e ozonit janë më të larta nga ato të dioksidit të azotit , me përjashtim të disa zonave me intensitet të lartë të trafikut. Përveç kontributit nga automjetet dhe industrinë , për përqëndrimet e ozonit duhet të marrim parasysh dhe kontributin nga shtresa e ozonit në atmosferë. Transporti rrugor është një burim kryesor i shumë ndotësve të ajrit, në veçanti në zonat urbane. Dendësia e trafikut, mosha mesatare e parkut të automjeteve, si dhe mungesa e kontrollit të shkarkimeve të gazta nga automjetet, çojnë në rritjen e shkarkimeve duke reduktuar cilësinë e ajrit të mjedisit në përgjithësi. Bllokimet nga trafiku për shkak të menaxhimit joeficient të tij rrisin shkarkimin e këtyre ndotësve. Variacionet sezonale në përqëndrimet e këtyre ndotësve janë të lidhura me ndryshimet meteorologjike si: (temperatura, lagështia relative, shpejtësia e erës dhe rrezatimeve diellore). Përqëndrime të larta të NO₂ ka dhe ne dimer, për shkak të dispersionit të ulet të erës dhe ndotja ngelet mbi sipërfaqen e tokës në një lartësi rreth 80-100 m.

Rekomandime

Studimet e fundit në fushën e shëndetësisë e kanë klasifikuar kancerin në pjesën më të madhe të formave të tij si "Sëmundje mjedisore". Vendet të zhvilluara si Kina por dhe vende europiane, janë përballur vitet e fundit me probleme të mëdha lidhur me shkarkimet e larta në ajër ku prezenca

e smogut është shfaqur në nivele alarmante. Është detyrë dhe prioritet e cdo qeverie implementimi i politikave parandaluese dhe mbrojtëse në fushën e mjedisit, përmes kontrollit të shkarkimeve të drejtpërdrejta dhe indirekte.

Qytetet	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Vlorë	32.77 µg/m ³	23.31 µg/m ³	35.09 µg/m ³	30.39 µg/m ³	31.62 µg/m ³	24.14 µg/m ³	17.38 µg/m ³	20.58 µg/m ³	22.2 µg/m ³
Berat	26.92 µg/m ³								
Lezhë			46.89 µg/m ³						
Norma Vjetore e BE	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³	40 µg/m ³

Figure 17.Vlerat mesatare të PM10 të monitoruara gjatë periudhës Prill-Dhjetor 2021. (Burimi: AKM)

- Zhurmat

Zhurmat përkufizohen si tinguj të padëshirueshëm, përgjithësisht prezente në cdo ambient ku ushtrohet aktivitet human, të gjeneruara kryesisht nga transporti dhe aktiviteti industrial. Ekspozimin i qenieve humane përballë këtyre tingujve mund të ndikojë negativisht në shëndetin psikologjik dhe fiziologjik. Si rezultat, zhurmat mjedisore janë studiuar dhe monitoruar nga shumë qeveri dhe institucione në mënyrë që të vendosen standarte dhe të hartohen ligje për nivelet e shkarkimit të zhurmave. Direktiva Europiane 2002/49/EC e Bashkimit European instrukton rreth mënyrës si mund të shmangim, parandalojmë apo reduktojmë efektet negative të ndikimit të zhurmës në shëndet.

Gjithnjë e më shumë ndotja akustike është duke u rritur dhe duke u shfaqur si një rrezik mjedisor "i dukshëm". Efektet e zhurmave grumbullohen tek individi si ngjarje zhurme, me efekte negative në dëgjim, psikike dhe mënyrën e jetesës. Presioni akustik është një matje bazë e vibracioneve të ajrit që përbëjnë zhurmën. Meqënëse intervali i presionit akustik, që auditori human mund të zbulojë (dallojë), është shumë i gjerë këto nivele i matim me një shkallë logaritmike me njësi decibel (dB).

Lezhë	Laeq Ditën	Laeq Natën	Koordinatat
Kryqëzimi Lagjja Gurra	63.02	48.3	41° 46'31.90"N 19°38'09.30"E
11 Janari	62.26	51.37	41° 46'49.64"N 19°38'36.63"E
Niveli kufi	55 dB	45 dB	

Figure 18.Niveli i zhurmave për periudhën e ditës dhe natës, Lezhë. (Burimi: AKM)

Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegulles dhe borës, shpejtësia e erës nuk ishte më e lartë se 5 m/s, mikrofoni ishte i mbrojtur me kufje antierë. Zinxhiri i matjeve ishte në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994.

Faktorët që kontribojnë në rezultatet e marra nga monitorimi i zhurmave:

1. *Fluksi i madh i automjeteve në akset rrugore ku u vendos aparati i monitorimit të zhurmave.*
2. *Gjëndja motorike e automjeteve në qarkullim dhe mosha e vjetër e tyre.*
3. *Punime ndërtimesh në pika të ndryshme, të cilat rritin artificialisht nivelin e zhurmave urbane.*
4. *Mungesa e brezit mbrojtës të gjelbër midis zonave të banuara dhe rrugëve kryesore.*
5. *Mungesa e masave minimizuese për zhurmat gjatë ndërtimit të rrugëve.*
6. *Mungesa e "Zonave të Qeta" në qytete.*
7. *Mungesa e theksuar e vendparkimeve.*

- Menaxhimi i Mbetjeve

Politikat për mbrojtjen e mjedisit, permiresimi i infrastruktures institucionale, forcimi i rolit dhe bashkepunimit midis institucioneve qendrore dhe lokale, ndergjegjesimi i publikut dhe angazhimi i te gjithë aktoreve te interesuar per administrimin e mbetjeve kane qene nje nga objektivat me kryesore dhe te rendesishme te legjislacionit dhe strategjise kombetare. Rendesia e synimi kryesor eshte zbatimi i plote i tyre duke filluar me parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve, riciklimin, trajtimin e tyre per shfrytezimin e nxehtesise apo energjise per qellime industriale, shtepiake etj, dhe depozitimi i tyre ne landfill. Nje vend te rendesishem ne zbatimin e legjislacionit tone dhe direktivave te Bashkimit European ka trajtimi dhe shfrytezimi i mbetjeve industriale. Mbetjet industriale pervec nevojës dhe rendesise se riciklimit dhe perdorimit te tyre, kane vlera ekonomike ne shfrytezimin e energjise termike te gjeneruar gjate procesit te incinerimit (djegjes). MM eshte ne procesin e miratimit te Strategjise Kombetare dhe Ligjit per Administrin e Integruar te Mbetjeve per periudhen 2010-2025. Zbatimi i tyre dhe nje seri vendimesh te reja te KM, do ti jape nje shtyese perpara trajtimit te integruar te mbetjeve duke i shmangur ato ne venddepozitim te tyre, duke zbatuar objektivat e Direktives te KE mbi Landfillin.

- Grumbullimi i Mbetjeve te Ngurta

Mbledhja e mbetjeve te ngurta dhe depozitimi i tyre eshte pergjegjesi e Bashkise e Lezhës (BL).

- Formacionet gjeologjike

Rrethi i Lezhës përfshihet në tre zona gjeologo-strukture karakteristike. Ato janë: Mirdita, zona e Krastë-Cukala të dhe zona e Krujës. Me punime kërkim-zbulimi janë vlerësuar rreth 0.5 milionë ton mineral bakri të tipit kuarc sulfur në skajin verilindor të rrethit dhe një varg shfaqjesh në velle të vendit Zef Sul e Qaf Kingjel bakri të pasur në rrafshin e mbihypjes së madhe. Në zonat kufitare me Lezhën janë zbuluar dy vendburime të nikelit sulfur me praninë e arit që janë vazhdim i ketyre brezave dhe justifikojnë investimet e mundshme për kërkim-zbulim gjithnjë me teknike e teknologji të re. Në rajonin e Lezhës përvizohen 2 horizonte platinmbajtëse, njëri me dunitet me pikëzime kromi dhe tjetri në dunitet të disa niveleve që shoqërohen me nikël sulfur. Përqendrimet e platinit vërehen edhe në gabro, gabro sideronite. Në gjithë magmatiket e Lezhës kemi rreth 5-6 mijë km² fushe kërkimi.

Punimet në bregdet të Tales, Rrilet kanë zbuluar mbi 5.5 milion ton rutil, zirkon, ilmenit, kromit, granatë, kallaj. Në nënzonën e Krastës në fushën e Zejmenit në dy shpimet e kryera është takuar qymyr koks në shtresa të holla: në thellesinë 346-346.35m me fuqi kalorifike 5621kal/gr,

permbajtje e squfurit 2.62%, hiri 7.78. Lezha ka ne territorin e saj mbi 40% te llojeve te mineraleve jometalore te vendit tone sipas V. Dukës.. Ne rajonin e Kashnjetit takohet nje mozaik i shumellojshem duke perfshire gjithë prejen e ofioliteve Shqiptare. Ketu takojme bazalte per aeroporte e autostrada, magmatiket per mermere granitike, per veshje te brendshme e te jashtme deri tek monumentet. Po ne rajonin e Kashnjetit jane zbuluar rezerva te medha kaolinash (monmorillonite) qe perdoren ne 100 fusha si dhe ranoret mikrokokrrizore per veshje ndertimesh.

Ne ndertimin gjeologjik te zones sone takohen depozitimet e meposhteme te cilat duke filluar nga ato me te vjetrat tek ato me te rejat jane:

kQh₂ – Depozitimet lagunoro-kenetore te Kuaternarit, te perfaqesuara nga nje perzierie heterogjene rere e surere, me lende organike $\frac{1}{2}$ te dekompozuar.




Figure 19. Fragment nga harta gjeologjike e zones

- Sizmiteteti

Territori i Bashkisë Lezhë ndodhet përgjatë brezit Adriatiko-Jonik, ku ndër vite kanë ndodhur një sërë tërmetesh të fuqishme. Zonat e shkëputjeve aktive janë pikërisht zonat sizmoaktive (ku gjenerohen herë pas here tërmetet), të konfirmuara nga fakti se epiqendrat e tërmeteve përqendrohen gjatë shkëputjeve, ose zonave të shkëputjeve aktive. Zona e Bashkisë së Lezhës vlerësohet me potencial sizmik me magnitudë 6.0-7.0 shkalla Rihter dhe intensitet epiqendror 8-9 ballë MSK-64. Vlerësimi i rrezikut sizmik probabilitar i zonës ku zë vend Bashkia Lezhë është bazuar në studimin e rrezikut sizmik probabilitar për Shqipërinë, i botuar nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë në vitin 2011 (Aliaj, Koçiu, Muço, & Sulstarova, 2011). Vlerat e shpejtimit maksimal të truallit – PGA dhe të shpejtimit spektral – SA janë llogaritur për truall shkëmbor, për dy nivele: 10 % probabilitet tejkalimi në 10 vjet dhe 10 % probabilitet tejkalimi në 50 vjet.




Figure 20. Tërmetet dhe prekshmëria në territor

- Zhvillimi ekonomik

Në kontekstin e zhvillimit ekonomik, nëse do të shohim indikatorët e tregut të punës për këtë qark, shohim se kemi një kontribut të ulët në raport me qarqet e tjera. Numri i ndërmarrjeve ekonomike që operojnë në Qarkun e Lezhës është 3030 ndërmarrje për vitin 2011. Në përqindje, themi se vetëm 3% e ndërmarrjeve ekonomike janë vendosur në këtë qark. Tregues të rëndësishëm ekonomik për zhvillimin e qarkut janë papunësia dhe ndihma ekonomike që marrin familjet. Për vitin 2012, katërmujorin e fundit, numri i të papunëve në këtë qark është 15021 individë. Pra qarku i Lezhës renditet i pesti për nga numri i të papunëve, pas Qarkut të Tiranës, i cili përmban numrin më të lartë të të papunëve, Qarkut Shkodër, Elbasan dhe Fier. Shprehur në përqindje niveli i papunësisë për këtë qark është 11% ndërsa në rang kombëtar është 12.82%. Sipas sektorëve, numri më i lartë i të punësuarve është në sektorin privat. Kështu në qarkun Lezhë, në vitin 2009, sektori privat kontriboi me 82.1% të të punësuarve, ndërsa në nivel vendi sektori privat kontribon me 83.5% të numrit të punësuarve. Është e rëndësishme për tu bërë një dallim midis zonës rurale dhe urbane të qarkut të Lezhës për sa i përket treguesve të rritjes ekonomike. Në komunat malore që ndodhen larg zonës së qarkut, treguesit ekonomik janë më ulët se ato në nivel qarku.

- Turizmi

Qarku i Lezhës me pozitën e favorshme gjeografike, me burimet natyrore turistike dhe me numrin e madh të objekteve historike dhe arkeologjike, ka mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit. Në këtë qark ndodhen 34 monumente natyre dhe 21 objekte kulti, muzeale, arkeologjike dhe historike. Turizmi përbën degën më me shpresë për zhvillimin ekonomik të rajonit tonë. Pastërtia ekologjike e mjedisit tokësor, ujqor e ajror, prania floristike me pyje, lëndina e livadhe, fauna e shumëllojshme, klima e përshtatshme e të tjerë faktorë, tregojnë se ekzistojnë të gjitha mundësitë për zhvillimin e

një turizmi bashkëkohor dhe të qëndrueshëm me të gjitha llojet e pasurive turistike: detare, lagunore e luginore (luginat e lumenjve) e ndër të tjera turizëm malor. Lezha është vendi ideal ku mund t'i bësh të tëra, në një vend të vetëm.

- *Popullsia, shendetesia dhe arsimi*

Popullsia e qarkut të Lezhës përbën më pak se 6% të popullsisë së vendit dhe është e vendosur në 21 njësi të qeverisjes vendore të organizuara në tri rrethe: rrethi Kurbin (4 njësi me qendër Laçin); rrethi Lezhë (10 njësi me qendër Lezhën) dhe rrethi Mirditë (7 njësi me qendër Rrëshenin). Në vitin 2011, popullsia e qarkut të Lezhës ishte 134 027 banorë, 49 përqind (65633 banorë) e të cilëve jetonin në rrethin e Lezhës, 16 përqind (22,103) në rrethin e Mirditës dhe rreth 35 përqind (46 291 banorë) në rrethin e Kurbin (INSTAT, Census 2011). Popullsia është 65,633 banorë ose 49 përqind e popullsisë së qarkut të Lezhës dhe është shpërndarë në 10 njësi të qeverisjes vendore. Lezha ka popullsinë më të madhe krahasuar me dy zonat e tjera funksionale të këtij rajoni. Popullsia e Lezhës është afërsisht 3 herë me e madhe se popullsia në Mirditë (22 103) dhe 1.4 herë me e madhe se popullsia në Kurbin (46 291) (INSTAT, Census 2011). Numri i femrave është 9.2 përqind më i ulët se ai i meshkujve.

Njesite Vendore	DEMOGRAFIA								
	Siperfaqe km ²	Banesa	Popullsia 2001	Popullsia 2011	Ndryshimi popullsise 2011/2001 (%-je)	Meshkuj	Femra	Urbane	Rurale
	456.9	22874	67714	65633	-3.1	32947	32686		
Lezhe	5.5	5968	14420	15510	7.6	7659	7851	15510	24835
Shengjin	53.4	4080	6807	8091	18.9	4073	4018		
Balldre	91.2	1778	7203	6142	-14.7	3096	3046		
Dajç	35.2	1300	5183	3834	-26.0	1907	1927		
Blinisht	38.1	1142	4238	3361	-20.7	1638	1723		
Kallmet	18.1	1487	5493	4118	-25.0	1976	2142		
Kolç	38.1	1282	4923	4228	-14.1	2080	2148		
Zejmen	42.2	1422	6713	5660	-15.7	2794	2866		
Shenkoll	32.4	3637	8894	13102	47.3	6890	6212		
Ungrej	102.7	778	3840	1587	-58.7	834	753		
Kombetare	28748	1012400	3069275	2800138	-8.8	50.1	40.9		

Figure 21. Demografia e Qarkut Lezhë

Arsimi në ZF të Lezhës ofrohet nga dy sektorë: sektori publik dhe ai privat, nga të cilat 86 përqind e institucioneve arsimore janë institucione publike. Të dhënat e Drejtorisë Rajonale Arsimore Lezhë tregojnë se në vitin 2014 në ZF zhvillojnë veprimtarinë e vet 55 institucione arsimore të sistemit parashkollor (kopshte), 59 shkolla të sistemin 9 vjeçar, 13 shkolla të arsimit të mesëm të përgjithshëm dhe 1 shkolle arsimit profesional. Numri i përgjithshëm i nxënësve është përkatësisht; 2345 nxënës në sistemin parashkollor, 9020 në sistemin 9 vjeçar, 2724 në arsimin e mesëm dhe 559 në atë të mesëm profesional. Në vitin 2014–2015, numri i kopshteve në Lezhë është 8.4 për çdo 10 000 banorë. Ky indikator është shumë afër indikatorit kombëtar. Numri i fëmijëve për çdo edukatore është mesatarisht 20 fëmijë. Numri i shkollave 9-vjeçare është 8.9 për 10 000 banorë. Numri i nxënësve për çdo mësues është mesatarisht prej 15.6 nxënës. Numri i shkollave të mesme është 2.0 për 10 000 banorë. Numri i mësuesve për 10 000 banorë varion nga 12–40, me një mesatare prej 24. Numri i nxënësve për çdo mësues është 15.7 nxënës. Institucionet arsimore publike janë të shpërndara në të gjithë bashkinë. Të gjitha komunat kanë shkolla 9 vjeçare dhe të mesme.

Shërbimi shëndetësor ofrohet nëpërmjet shërbimit shëndetësor parësor dhe atij spitalor. Qarku Lezhë ka 3 spitale me 319 shtretër si dhe 92 qendra shëndetësore dhe një numër total mjekësh prej 155. Distanca nga qendra më e afërt shëndetësore/mjeku më i afërt në zonat urbane është 23 minuta, ndërsa në zonat rurale, 19 minuta. Në Bashki kujdesi shëndetësor parësor ofrohet përmes një qendre shëndetësore dhe katër ambulanca. Shërbimi shëndetësor parësor ofron shërbim mjekësor të specializuar që mbulon i). shërbim mjeku të familjes, ii). shërbim pediatrik, iii). konsultor të nënës dhe fëmijës, iv). kardiologji, v). mikrokirurgji, vi). shërbim mini laboratorik (dy laboratorë) si dhe vii). shërbim urgjence mjekësore Spitali rajonal, i ndodhur në Qytetin e Lezhës, ofron shërbime të kujdesit shëndetësor në patologji, obstetri- gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Numri i punonjësve është 35 mjekë specialistë, 104 infermierë, 17 staf mjekësor (laborantë, farmacistë) dhe 100 veta personel ndihmës dhe administratë. Aktualisht ky spital ka një kapacitet prej 162 shtretërish. Numri i shtretërve për 10,000 banorë është 55. Numri i pacientëve të shtruar gjatë vitit 2013 ishte 7,031 prej të cilëve 27% ishin prej rretheve të tjera të qarkut Lezhë.

- Kultura

Shoqeria , gjuha dhe kultura

Traditat e lashta në të cilat shkrihen besimet e ndryshme, manifestohen në një seri festash e ceremonish që shpesh bazohen në marrëdhëniet e ngushta të njeriut me natyrën. Gjuha zyrtare-shqipja- flitet dialekti gegërisht. Festat, martesat, jeta e përditshme, shoqërohen nga një muzikë e vecantë dhe karakteristike për këto zone.

Artizanati dhe zejtaria

Artizanati ndertimor lidhet me prodhimin e tjegullave dhe pllakave prej balte, me pocerine vendase shumë të zhvilluar. Një numër tjegullash mbajnë vlerën e pronarit të punishtës me emrin EOBTARIO. Ky emër lidhet me të njëjtin emër, që gjendet edhe me monedhat e gur-varret e zbuluara në qytetin e Durrësit. I madh është numri i amforave të zbuluara këtu, disa prej të cilave kanë edhe vula në formë simbolesh apo monogramesh. Në disa amfora vula ka të rafiguruar lulen e sheges, simbol ky i njohur për amforat me prejardhje nga ishulli i Rodit. Një vule e një amfore tjetër mban emrin ilir Gent dhe emrin tjetër po ilir Suri, pronar i punishtëve vendase. Janë gjetur edhe ene tryeze me kanilyra të tipit inafie dhe ene të tipit megara. Këto objekte i perkasin si kohë shek.III-i para Krishtit. Me interes janë dhe objektet prej bronz apo dhe prej hekuri si fibula, byzilyke, unaza, gjilpera, grepa peshkimi, thumba dhe gozhde të vogla, maja heshtash, shpata etj. Nga një gur varri i gjetur në Lezhë, i shek.II para Krishtit, mesojmë emrin e arkitektit Hieroni, i biri i Leonit. Është fjala për një arkitekt, që ka punuar në këto qytet ilir.

Kultura dhe etnografia

Katedralja e Shën Nikollës ka një rëndësi të posaçme historike për shqiptarët, jo vetëm për Kuvendin e Lezhës, por edhe si vendvarrim i Gjergj Kastriot Skenderbeut. Kjo katedrale, në shek. XVII, që shndërruar në xhami. Themelet e saj janë të shek. XIV, katedralja është e tipit bazilikë me gjatësi 17 m dhe gjërësi 8 m. Ruhet në muret e saj një afresk i Shën Nikollës. Sot rrënojat e Katedrales së Shën Nikollës (Xhamia e Selimijes) janë shruar në memorialin e Gjergj Kastriot Skenderbeut, padyshim një nga monumentet më të mëdha të historisë kombëtare të shqiptarëve në të gjitha kohërat.

2.4.2 Identifikimi I ndikimeve te mundshme negative ne mjedis

Objekti: “RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESE, SHTESE ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE “MARASH GJONI” NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE”

Vendodhja: Bashkia Lezhë

Kategoria e Lejes: VNM Paraprake




Figure 22.Pozicioni i Parceles qe do te zhvillohet



Figure 23.Pozicioni ne lidhje me zonen urbane

- Përshkrimi i proceseve teknologjike të ndertimit te objektit

Proceset teknologjike ne kete projekt jane ato te fazes ndertimore, nepermjet punimeve te ndertimit te cilat kryhen nga firma ndertuese dhe ne vija te pergjithshme konsistojne si me poshte: Rrethimi i sheshit te ndertimit, pastrimi i sheshit dhe largimi i te gjitha mbetjeve inerte, germimi dhe betonimi (betoni hidhet ne vend), etj.

Pastrim i te gjitha mbetjeve te ndertimit dhe krijimi i nje peizazhi te kendshem e te paster te zones, perfshi mbjelljet e ndryshme.

Ndikimet negative ne mjedis

Aktivitetet qe do te japin ndikime te mundshme negativisht ne mjedisi gjate te gjitha fazave te zbatimit te projektit, asaj parapregatitore, te ndertimit te objektit jane veprimtarite si:

- o Gërmimet e tokës dhe dhe pastrimi e sistemi i sheshit ku do të ndertohet objekti;
- o Percaktimi i trajtimi i rrugeve për qarkullim të automjeteve në objekt dhe lidhja me ato jashte tij.
- o Rrethimi i sheshit të ndertimit.
- o Ndertimi i magazines së perkoheshme dhe vendi i qendrimit te mjeteve, parkimin;
- o Hapja e themeleve, punime germimi;
- o Ndërtimi i themeleve dhe krejt objektit;

Keto veprimtari mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe social –ekonomik nga:

- o Zenia e përkohëshme ose e përherëshme e tokës;
- o Përdorimi i makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- o Përdorimi i materialeve të ndërtimit;
- o Përdorimi i karburantit gjatë ndërtimit;
- o Gjenerimi i emisioneve në ajër;
- o Gjenerimi i zhurmave nga automjetet per ndertimin si dhe i makinerive e pajisjeve që përdoren per ndertimin e objektit;
- o Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të prodhuara.

Kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes janë:

- o Marrja e përherëshme e tokës për ndertimin e objektit;
- o Gjenerimi i zhurmave nga rritja e pranise se automjeteve;
- o Rritja e pranise se banoreve dhe e presionit në mjedisin biofizik.

Ndikimi i karakteristikave aktuale klimatike mbi aktivitetet e projektit

Vendi ku zbatohet projekti, karakterizohet nga klimë tipike mesdhetare me dimër të butë e me reshje dhe verë e nxehtë dhe e thatë. Këto karakteristika klimatike janë të përshtatshme për qëllime në të gjitha fazat e zhvillimit të projektit. Kështu, punimet e ndërtimit mund të realizohen pothuajse gjatë gjithë vitit. Megjithatë është sugjeruar për të shmangur periudhat kur bie shi në punimet në mjedise të hapura e sidomos në lartësi.

- Ndikimet ne biodiversitet

Ndërtimi i magazinës së përkohshme me ambientin zyrë për ndjekjen e punimeve, pastrimin i terrenit ku do të ndertohet objekti, hapja e koridoreve të përkohëshme qarkullimi tek fronti i punes, punime të tokës për themelet e shtresat e objektit, transporti i materialeve, zhurma dhe vibracionet e krijuara nga aktivitetet e demolimeve dhe ndërtimit, etj, përbëjnë burimet kryesore të ndikimeve në burimet ekologjike dhe të biodiversitetit në këtë zonë.

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat i modifikuar nga njeriu e jo natyror, shqetësime të kafshëve (kryesisht shpëndëve) të mjedisit urban ose mergim i përkohshëm i atyre të zonës më larg sheshit të ndërtimit shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe mekanizmave, ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme që mbështesin biodiversitetin.

Duke qënë se vendi ku do të ndërtohet objekti është mjedis urban me dendësi deri të lartë të objekteve ndërtimore, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta përsa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i ulët.

Ndikimet në faunë

Ndikimet kryesore në grupe të ndryshme të faunës nga ndërtimi i objektit të propozuar mund të klasifikohen si shqetësim për elementët faunistik urban.

Ndërtimi përfshin pastrimin e vegjetacionit në vatra të pakta të gjetura, gjermimit të dheut, dhe lëvizja e mjeteve apo pajisjeve mbi rrugët dhe terren, ngarkimin dhe shkarkimin e materialeve dhe aktiviteteve të tjera mund të rezultojë në lëndime apo eliminimin e kafshëve.

Për pozicionin e sheshit të ndërtimit, ndikimet e tilla nuk mund të jenë të rëndësishme, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmash të cilat nuk janë të konsoliduara si komunitete apo popullata. Elementët faunistikë nuk karakterizohen nga ndjeshmeri e veçantë që të ndikohen në mënyrë specifike apo që të jenë të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë në këtë mjedis urban gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i rikthyeshëm.

Gjitarët

Aktiviteti mund të ndikojë në humbjen e drejtpërdrejtë duke tjetërsuar mjedisin përmes punimeve të ndërtimit, veçanërisht realizimin e themeleve. Në shumë raste, humbja e vendit nuk ka gjasa të ketë një ndikim potencial në popullatën e specieve. Këtu nuk ka mjedise me popullata të qëndrueshme të gjitareve por mund të jenë në gjëndje të largohen nga zona për të shmangur rrëmujën (siç janë lakuriqet e natës). Ndikimi mund të vlerësohet i ulët dhe i kthyeshëm.

Jo vertebrorë, amfibet dhe zvarraniket, nuk përfaqësohen nga popullata të qëndrueshme veç atyre që banojnë në mjedise e strehe pranë banesave të ulta etj. Gjatë aktiviteteve të ndërtimit ato mund të dëmtohen ose dalin dalin nga mjediset ku janë strehuar. Dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin e drejtpërdrejtë të popullsisë së amfibëve dhe zvarranikëve, si dhe faunës jovertebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet shumë e ulët.

- Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESE, SHTESE ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE "MARASH GJONI" NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE qëndron në terren urban me vlera të ulëta të biodiversitetit, (mungesë së specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara, zonat e mbrojtura, etj).

Nuk ka argumenta që ky objekt të jete pengesë e rrugeve migruese të shpendeve të ujit.

Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.

- Ndikimet në ujë

Ujërë nentokësore

Kjo zonë, e cila është e përbërë nga shtresezimë që nuk ndikojnë në ndonjë aquifer të rëndësishëm i cili të influencohet negativisht nga shkarkimet e mundshme por behet pjesë e një mjedisi urban të konsoliduar. Megjithatë shtresezimet ujëmbajtëse mund të ndotet nga derdhjet e naftës dhe të ujërave të përdorura të krijuara gjatë punimeve të ndërtimit të ndërtimit.

Ndikimet e mundshme mbi ujërave nentokësore:

- o Ndikimet e mundshme mbi ujërave nentokësore nga punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- o Makineritë që punojnë nëndërtim dhe kamionet transportues, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.
- o Rreziku i ndikimeve negative në ujin në objektet e furnizimit duke përfshirë zona të kufizuara rreth objektit.

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nentokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të mesëm e të madhësisë së mesme.

Ndikimet e mundshme mbi ujërat sipërfaqësore:

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me veprimtaritë përgatitore të sheshit dhe veprimtaritë e ndryshme ndërtimore (ndërtimi i koridoreve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; themelet, ndërtimi i objektit etj), përfshijnë:

- o Rritja e pezullive në ujërat nga germime e dherave;
- o Rreziku i mundshëm i ndotjes nga lëndë djegëse si nafta, mbetjet e ngurta, etj; Rreziku i ndikimit negativ në objektet e furnizimit me ujë;
- o Erozioni në anët e gropës së hapur për ndërtimin e themeleve e katit nentokësor dhe sedimentimi;
- o Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

- Ndikimet në tokë

Nga ndërtimi i objektit do të ketë një humbje të sipërfaqes së patrajtuar aktualisht nga ndërtimet infrastrukturore, objekte ndërtimore, nga punimet tokësore. Makineritë e ndërtimit si dhe makinëritë e renda që bëjnë rregullimin e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojnë tokën në zonën rreth objektit.

Ndikimet e mundshme:

- o Humbja e tokës së lirë nga ndërtimi i objektit;
- o Ngjeshja e tokës nga mjetet qarkulluese në zonën rreth objektit gjatë punimeve të ndërtimit;
- o Ndotja e tokës, e cila mund të ndodhë me derdhjet e naftës nga transporti dhe mjeteve të punës ose përmes ujërave të zeza dhe mbetjet urbane nga sektori i punimeve gjatë aktiviteteve të ndërtimit.

Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohet të një rëndësie të vogël dhe me masë të kufizuar.

- Tektonia dhe sizmitet

Ndikimet e mundshme:

Nuk ka ndikime të mundshme që mund të gjenerohen nga aktivitetet e ndërtimit por dëmet e mundshme për objektin mund të ndodhin në rast të tërmeteve në qoftë se ata janë të përshkruar nga linja tektonike; etj

Projekti duhet në perputhje me vertetimin sizmik të sheshit të ndërtimit të lëshuar nga Instituti i Sizmiologjise, për parametrat e marre për llogaritjen e ngarkesës sizmike si intensiteti sizmik i truallit të ndërtimit sipas shkalles Merkalit e kategorisë së truallit.

- Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka të tjera kërkesa të përdorimit të tokës gjatë fazave të operimit dhe mirëmbajtjes. Kërkesat për përdorimin e tokës janë plotësuar para fazës së ndërtimit, me qëllim ndërtimin e këtij objekti.

- Gjeologjia

Vendi ku vendoset objekti është e testuar nga ana gjeologjike nga ndërtimi I objekteve të tjera ndërtimore me volume ndërtimore e lartësi katesh të ngjashme. Nga punimet përgatitore të terrenit ku do të ndërtohet objekti mund të ndodhin fenomene të izoluara erozioni gjatë punimeve gërmuese e që janë me veprim të perkohshëm.

Keto ndikime të mundshme vlerësohen me probabilitet të ulët dhe me madhësi dhe shtrirje për aq kohë sa ndërtohen objekti.

- Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Ndikimet e parashikuara nga aktivitetet e operimit dhe të mirëmbajtjes që lidhen me parametrat gjeologjike, tektonike dhe sizmike në zonën e projektit nuk kanë ndonjë çështje specifike të panjohur që mund të merret në konsideratë. Ndërsa dëmet e objektit në rast të tërmeteve potenciale janë të mundura.

- Ndikimet në ajër

Vendi për ndërtimin e objektit është zonë urbane dhe cilësia e ajrit përgjithësisht është në nivele të pranueshme për zonat e banuara qytetase pa evidentuar rastet e ndotjes nga industria të caktuara më ndikim potencial ndotës në këtë qytet. Vllora nuk tejkalon standartin ditor të BE3 për PM10 si dhe PM 2.5, SO₂, NO₂ ndërsa për CO ka tregues të rritur në krahasim me standartet kryesisht për shkak të rritjes së numrit të automjeteve qarkulluese në rrugët e qytetit.

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojnë pluhura janë ndërtimet e sektorit të punimeve, rregullime rrugore, pastrim bimësie, ndërtimi i objektit dhe themelet e strukturave mbajtëse si dhe emisionet e gazit nga mjetet e transportit dhe pajisjet e ndërtimit. Pluhuri, grimcat dhe emetimet e gazeve mund të ndikojnë negativisht në biodiversitetin, burimet ujore dhe shëndetin e punëtorëve dhe të popullatës lokale. Shkarkimet në ajër mund të specifikohen emetimet të pluhurave dhe grimcave (pm10). Emetimet me të mëdha pluhurave mund të ndodhin gjatë orëve të punës në aktivitetet ndërtimore.

Pluhuri nuk shkakton ndryshime afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në mjediset në afërsi shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankësime, por që keto ndikime janë të perkohshme, ose gjatë fazës përgatitore dhe asaj të ndërtimit.

Ndërsa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri nëpërmjet erës, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht e vogël, çdo efekte

anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit. Duke qënë së grimcat PM10 janë mjaft të vogla, ato tërhiqen në mushkeri gjatë frymemarrjes dhe japin ndikim potencial për shendetin.

Emetimet e gazeve: Ndotësit kryesorë në lidhje me të cilat janë të lidhur me trafikun rrugor gjatë ndërtimit janë NO₂, PM10, CO, benzen (C₆H₆) dhe benzopireni (C₂₀H₁₂). Emetimet e NO₂ dhe PM10 janë më shumë gjasa për të tejkaluar standardet përkatëse të cilësisë së ajrit për vëndin tonë në objekt në momente piku të punimeve si dhe do të ndjehet në zonën 3 Sipas Raportit të gjendjes së mjedisit në RSH, 2017 që është përiferike ose ngjitur me kantjerin e ndërtimit. Nuk parashikohet që keto ndikime të shtrihen dhe të jetë potenciale në cilësinë lokale të ajrit.

Gjatë procesit të ndërtimit kontraktori duhet të zbatojë nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis" dhe VKM Nr. 248, datë: 24.03.2003 "Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre".

- Ndikimi në peizazh dhe vizualiteti.

Gjatë fazës së ndërtimit të objektit, do të ketë ndikime në vlerat e peizazhit urban dhe të pamjes në tëresi përmes ndryshimeve që do të ndodhin nga: pastrimin i vegjetacionit të vendit të ndërtimit rruget e mundshme të perkoheshme të hyrjes në objekt.

o nga punimet e sheshit të ndërtimit duke bërë demolime të strukturave e objekteve ekzistuese;

o nga qarkullimi i kamioneve të rëndë dhe nga prania e të gjithë aktivitetit ndërtimor.

Nga përfundimi i objektit do të ketë ndikime në peizazhin urban në këtë lagje nga prania e objektit të përfunduar, por përceptimi do të jetë i moderuar për faktin se kemi të bëjmë me volume të reja objektësh ndërtimorë por që sistemojnë mjaft element urbane që lidhen me vijën e ndërtimit apo lartësinë e kateve. Ndikim pritet të jetë i moderuar deri të mesëm mbi peizazhin.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Në kushtet kur objekti do të jetë një zhvillim i ri urban duke u ekspozuar më së theksi si objekt zhvillimor, ndikimi në peizazh mund të klasifikohet i moderuar e me ndjeshmëri të mesme. Si një masë zbutëse është sugjeruar është rritja sa më shumë që të jetë e mundur e koridoreve e këndeve të gjelbërta rreth objektit, të shikohet mundësia e organizimit të hapësirave e strukturave për zhvillimin e gjelberimit në vetë objektin.

- Përmbytjet

Nuk ka asnjë ndikim të parashikuar të përmbytjeve gjatë fazës së operimit. Ndikimin e mundshëm të ngjarjeve të përmbytjeve në zhvillimin e projektit, veçanërisht marrja parasysh e ndikimeve nga efektet nga ndryshimet klimatike zbuten nga marrja e masave të parashikuara.

Marrja e masave për të mos dëmtuar infrastrukturën kulluese gjatë ndërtimit si dhe aplikimi i themeleve të strukturave të objektit sipas praktikave me të mira e kodeve ndërtimore garantojnë mbrojtjen e nga përmbytjet gjatë operimit. Zbatimi i masave të duhura zbutëse, çon në një ndikim që vlerësohet i një rëndësie të vogël.

- Ndikimi në trashëgimisë natyrore dhe zonat e mbrojtura

Vendi për ndërtimin e objektit shtrihet në tokë të zhvilluar nga pikepamja urbane, me vlera të ulëta në drejtim të biodiversitetit. Nuk ka asnjë ndikim potencial të parashikuar në florën dhe faunën në

përgjithësi, dhe në specie endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti. Nuk ka zona të mbrojtura në afërsi të zonës së projektit.

- Çështjet social ekonomike

Në lidhje me kontekstin lokal, zona e prekur do të jenë përfituese drejtpërdrejtë nga aspekti ekonomik. Gjatë periudhës së ndërtimit, do të ketë një numër të konsiderueshëm të punëtorëve të ndërtimit që do të punësohen nga popullsia e zonës afër vendit ku zbatohet.

Përfitimet do të shkojnë për kompanitë lokale të ndërtimit të kontraktuar. Aktivitetet e ndërtimit ndikojnë e ofrojnë kushte të favorshme dhe inkurajojnë bizneset e reja, ose shërbimet për punëtorët e ndërtimit.

- Përdorimi i tokes

Ndërtimi i objektit zhvillohet në një sipërfaqe terreni pronë shteti, dhe nuk kemi të bëjmë shpronësime dhe kompensime.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Projekti do të kontribuojë për zhvillimet e mëtejshme urban në këtë lagje e permiresimin e mjedisit urban.

- Ndikimi në infrastrukturë

Efektet negative të infrastrukturës ekzistuese, që lidhen me ndërtimin e objektit, janë kryesisht:

- o Dëmtimi i infrastrukturës ekzistuese si pasojë e qarkullimit të kamioneve të rëndë e automjeteve të transportit.
- o Shqetësim mund të ketë edhe për rastet kur rruget hyrëse në objekt do të jenë të ngushta për automjetet.

Me zbatimin e masave përkatëse, ndikimi i mundshëm në infrastrukturë vlerësohet i një rëndësie të vogël dhe të masës lokale.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka asnjë ndikim të parashikuar e që të ketë lene gjurmë negative në infrastrukturën ekzistuese, gjatë operimit dhe mirëmbajtjes, por do të përmirsohet fleksibiliteti urban.

- Trashëgimia kulturore

I gjithë personeli në zbatim të projektit duhet të trajnohet për të ndaluar punimet në qoftë se ndonjë objekt me vlerë historike ose para-historike është gjetur. Nëse ndodh kjo, ndërtimi nuk duhet të fillojnë derisa të autorizohet nga institucioni publik kompetent për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Nga vezhgimet në terren si dhe nga prania e objekteve të ngjashme ekzistuese nuk pritet të ndodh një rast i tillë.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Nuk ka ndikim të pritshëm në trashëgiminë kulturore gjatë operimit dhe mirëmbajtjes. Procesi i përzgjedhjes së vendndodhjes ka lidhje me pronësinë dhe tiparet urbane të zonës, dhe nuk është dashur ndonjë shmangie që lidhet me praninë e objekteve të trashëgimisë kulturore e objekteve historike.

- Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës

Faza e ndërtimit të objektit të propozuar do të favorizojë punësimin e një numri të konsiderueshem puntorësh në zonën që pritet fillimi i punimeve të projektit. Punëdhënësi dhe të punësuarit do të jenë të detyruar të ndjekin përcaktimet e përfshira në aktet e ndryshme ligjore në fushën e punës dhe legjislacionit për mbrojtjen sociale. Masat duhet të jenë të përshkruara në drejtim të mbrojtjes

së të punësuarve. Këto masa përfshijnë ndërmarrjen e detyrave të caktuara nga ana e personelit të kualifikuar, dispozitat për pajisje të përshtatshme personale të mbrojtjes, shmangien e aktiviteteve gjatë kushteve të keqesuara të motit, për ofrimin e shërbimeve sanitare dhe pajisje të mirëqenies në vend, si dhe identifikimin e duhur të rrezikut dhe vlerësimit të tij. Këto masa, së bashku me angazhimin në përputhje me ligjet e shëndetit dhe sigurisë shqiptare do të sigurojnë themelin mbi të cilin do të bazohet shëndeti dhe siguria e punonjësve.

Kushtet e punës dhe kompetencat e punës do të përcaktohen në përputhje me legjislacionin përkatës shqiptar të punës. Mjedisi i qëndrimit dhe i punës për punëtorët do të jetë i përshtatshëm, i pastër, i sigurt, për të siguruar nevojat bazë të punonjësve.

Kompania zbatuese do të jetë përgjegjëse për Shëndetin dhe Planin e Sigurisë për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të punës. Investitori do të shqyrtojë dhe të miratojë këto plane dhe do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e performances së zbatuesit. Të gjithë punëtorët do të trajnohen në lidhje me rregullat dhe procedurat e duhura të sigurisë.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Qëllimi i të gjitha programeve të shëndetit dhe sigurisë në punë është për të nxitur një mjedis të sigurt për veprimtarinë njerezore e për banim. Funksionimi i objektit dhe mirëmbajtja do të kërkojë zbatimin e kërkesave ligjore që rregullojnë marrëdhëniet për godina banimi të mjedisëve të përbashketa. Ndërsa për objektet prone private në përberje të godinës janë përgjegjes pronaret e tyre në aspektin e sigurisë dhe të cilësisë mjedisore.

- Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Është e rëndësishme që komuniteti të njohe e të jetë i informuar në lidhje me vendin e zbatimit të projektit për arsye të levizjeve të pa autorizuar që mund të ndodhin në vendet e ndërtimit nga fëmijët dhe të rriturit e që mund të shkaktojnë pasoja të rënda për këta individë. Rrethimi i sheshit të ndërtimit dhe mbajtja nën kontroll, rrit masat e sigurisë në këtë drejtim. Zbatuesi I punimeve do të jetë i detyruar për të zhvilluar dhe zbatuar procedurat për të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e publikut. Kjo do të përfshijë trajnime për punëtorët dhe personelin e sigurisë për të parandaluar qasje të paautorizuara në vendet e ndërtimit, zonat e qarkullimit të mjeteve të ndërtimit, si dhe zonat e magazinimit të pajisjeve.

Gjatë fazës së ndërtimit, ka probabilitet minimal për punëtorët të vuajnë nga sëmundje të caktuara infektive. Çështjet e mundshme të shëndetit publik nga sëmundjet e ndryshme nga speciet vektoriale, nuk ka probabilitet të vlerësuar e të jetë i ndikueshem gjatë zbatimit të projektit.

Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes

Gjatë fazës operacionale, objekti nuk ka ndikime të cilat mund të konsiderohet si një rrezik shëndetësor të komunitetit. Gjatë fazës operacionale nuk do të lëshohen substanca ndotëse dhe të dëmshme në mjedis dhe nuk do të gjenerohen sasi të shumta mbeturinash. Në këtë aspekt projekti i propozuar nuk do të krijojë kushte mjedisore të cilat mund të çojnë në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore në zonën e projektit, por do të ndikojë në rritjen e cilësisë së kushteve arsimimit, të rritjes së aktiviteteve të shërbimit etj.

- Mbetjet e prodhuara

Në bazë të VKM Nr. 99, datë 18.2.2005 "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", mbetjet e ngurta që do të prodhohen nga ndërtimi në këto zone dhe do të jenë mbetje të tilla si:

17 Mbetjet e ndërtimit (përfshirë dheun e gërmuar dhe inertet nga prishjet)

17 09 04 materiale inerte te prodhuara nga punimet

17 04 05 hekur,

17 01 01 beton.

Grumbullimi i mbetjeve duhet te jete i diferencuar qe ne vendburim. Mbetjet inerte, dheu i gërmuar, dhe mbetjet e ambalazheve te paletave te materialeve te ndertimit duhet te trajtohen ne menyre te vecante. Mbetjet e pariciklueshme duhet të dërgohen në një landfill të miratuar.

Depozitim i mbetjeve inerte do të bëhet ne venddepozitim në baze te udhezimeve te Bashkise dhe ne perputhje me VKM Nr.575,date 24.06.2015 "Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte".

Transporti i mbetjeve inerte do të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me liçensë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

Vleresimi i rendesise se ndikimeve negative mjedisore

Ndikimi i mundshem ne mjedis	Kategoria		
Ne toke	I ulet	I mesem	I lartë
Ndotje e mundshme e tokes nga ndonje rrjedhje aksidentale te lubrifikanteve	+		
Biodiversiteti dhe peisazhi	I ulet	I mesem	I lartë
Modifikim i peisazhit ekzistues	+		
Ajer	I ulet	I mesem	I lartë
Emetim gazesh nga automjetet qe do te kryejne punimet		+	
Emetim zhurmash, vibracioni dhe aromash	+		
Ujera	I ulet	I mesem	I lartë
Ndikim në cilësinë e ujerave	+		

Shkalla e vleresimit te ndikimit	Përcaktimi
I ulët	Efekti potencial është nën standartet/limitet mjedisore të aprovuar
I mesëm	Efekti potencial është i detektueshëm por permbush standartet/limitet mjedisore të aprovuar
I lartë	Efekti potencial eshte mbi standartet/limitet mjedisore të aprovuar

2.5Përshkrim i shkarkimeve të mundshme në mjedis (problemet mjedisore qe mund te lindin)

- o Rrethimi i objektit me sinjalistiken e duhur

Objekti qe do te ndertohet ne nje nga zonat e banuara te Njesise Administrative Rrile, Bashkia Lezhe, pra ne zone me aktivitet te dukeshem, dhe si e tille zona do te pajiset me sinjalistiken edhe masat e marra per sigurimin teknik.

- o Prodhimi i pluhurave

Furnizimi i materialeve: Do të përdorin ose blejnë materiale nga impiantet ekzistuese guroret që veprojnë me leje dhe licenca të vlefshme mjedisore dhe të tjera. Dispozitat e duhura për këtë qëllim do të bëhen në dokumentet e kontratës si më poshtë.

Transporti i Materialeve: Operatorëve të kamionëve do të kërkohet që të mbulojnë ngarkesat e kamionëve, të shmangin transportimin e materialeve, në rrugët publike, gjatë orëve të trafikut në mëngjes (ora 8:00 deri në 9:00) dhe të përdorin rrugë alternative kudo që është e mundur për të minimizuar bllokimet e trafikut. Do të kërkohet që të përgatisë dhe të dorëzojë tek mbikëqyrësi i punimeve një plan të menaxhimit të trafikut para fillimit të punimeve, duke treguar rrugët dhe kohët që do të përdoren për shpërndarjen e materialeve jashtë dhe në vend. Asnjë transport material nuk do të lejohet deri në miratimin e planit të menaxhimit të trafikut.

- o Zhurma dhe pluhuri

Punimet do të kërkojnë që të kufizojnë aktivitetet në orët e punës të orarit të ditës dhe të përdorin pajisje me zhurmë. Vendet e ndërtimit dhe vendet e magazinimit të materialeve do të ujiten sipas nevojës për të kontrolluar pluhurin.

- o Ndërprerjet e trafikut dhe siguria e automjetit/këmbësorëve

Do të përgatisin një plan të menaxhimit të trafikut me masat e duhura për të kontrolluar dhe drejtuar trafikun dhe këmbësorët.

- o Ndikimi në Biodiversitet

Ky zhvillim, nuk prek hapësirat e gjelberta të qytetit pasi objekti për të cilin flasim ka pak bimesi. Sipas projektit të paraqitur rezulton se nuk do të ketë aspak shkarkime në burimet ujore përreth.

- o Ndërprerjet e trafikut dhe siguria e automjetit / këmbësorëve

Kontraktuesit do të përgatisin një plan të menaxhimit për të marrë masat e duhura për të kontrolluar dhe drejtuar punimet.

- o Shkatërrimi i mbeturinave të ndërtimit:

Materialet dhe mbeturinat e prishjes nga vendi i ndërtimit do të hidhen në përputhje me rregulloret lokale të mjedisit dhe në vendet e miratuara nga autoriteti mjedisor.

- o Krijimi dhe largimi i mbeturinave urbane

Gjatë punimeve të mevonëshme të rehabilitimit, dhe në fund do të rezultojë kërkesa për largimin e mbeturinave që do të kryhen në kohë dhe në vendin e caktuar, me miratimin nga Bashkia e Lezhës, pra do të jenë konform kërkesave të dhëna nga kjo Bashki. Mbetje të ngurta që prodhohen nga ndërtimi në këto zone janë mbetjet e ngurta urbane si plastike, qelqi, materiale letre, metale, mbetjet organike (paleta druri), materiale inerte të prodhuara nga punimet ndërtuese, si dhe dheu e mbetjet inerte që do të largohen nga sheshi i ndërtimit. Largimi i mbetjeve do të bëhet conform ligjeve Shqiptare duke kontraktuar një kompani të cilës ka licencën përkatëse për largimin e këtyre mbetjeve. Kjo do të realizohet pas zbardhjes së Lejes së Zhvillimit nga autoritetet përgjegjëse.

Referuar VKM Nr.99, datë 18.02.2005 Për miratimin e katalogut Shqiptar të

Klasifikimit të Mbetjeve", mbetjet që prodhohen klasifikohen me kodet:

20 01 01 Letër dhe karton,

20 01 02 Qelq

20 01 39 Plastikë

20 01 40 Metalet,

20 02 02 Dhera dhe gure

Depozitim i mbetjeve inerte do të bëhet në përputhje me **VKM Nr.575, datë 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte"**.

Transporti i mbetjeve inerte do të bëhet me mjete teknologjike të pajisur me licencë të tipit III.2.B në bazë të ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"

i ndryshuar dhe të shoqërohet me plotësimin e shtojcës 1 të VKM nr.229, datë 23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme" si dhe VKM nr.371, datë 11.06.2014 "Për percaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme".

o Furnizimi me baze materiale

Gjate fazave, si asaj pergatitore dhe te ndertimit te objektit, e deri ne fund me venien ne funksionim te tij, furnizimi me baze materiale, do te behet ne oret e vona. Ne kete menyre, nuk do te pengohet transporti i mjeteve dhe i njerezve.

o Klasifikimi i mbetjeve, mbetjet e rrezikshme

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.99, datë 18.2.2005 "Për Miratimin E Katalogut Shqiptar Të Klasifikimit Të Mbetjeve". Bazuar ne klasifikimin e mbetjeve, gjate ndertimit do te kete mbetje nge ndertimet (përfshire dhera të gërmuara nga zona). Mbetje te tille do te kete vetem gjate fazez se ndertimit, domethene do te kete volume dherash te gërmuara te cilat do te venddepozitohen ne nje siperfaqe te caktuar sipas planit te rehabilitimit. Mbetje të rrezikshme jane mbetjet:

"eksplozive", substancat dhe preparatet të cilat mund të shpërthejnë nën efektin e flakës ose të cilat janë më të ndjeshme nga goditja apo fërkimi dhe "oksiduese", substancat dhe preparatet të cilat kanë reaksione të fuqishme ekzotermioke kur bien në kontakt me substanca të tjera, veçanërisht me substanca të djegshme. "shumë të djegshme": mbetje vajrash dhe mbetje te karburanteve te lëngshme, te rrezikshme": substancat dhe preparatet, të cilat nëse thithen nëpërmjet frymëmarrjes, injektohen ose penetrojnë në lëkurë mund të shkaktojnë rrezik të kufizuar të shëndetit. Per ndertimin nuk nevojiten substanca te tilla, pra nuk do te kete asnje mbetje te rrezikshme ne territorin ku do te ndertohej .

Bazuar ne vendimin e KM nr. 371, datë 11.6.2014, "Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre" ne rastin e ndertimit te objektit nuk do te kete mbetje te tilla.

o Mbetjet e ngurta

Gjate aktivitetit per realizimin e projektit do te kete krijim pirgjeshe te materialit te ngurte te germuar por jo te demshme. Plani i vendgrumbullimit dhe rehabilitimit përfshin zonat ku do të realizohen punime depozituese dhe rehabilituese, si dhe volumen dhe llojin e punimeve.

Objekti do të zhvillohet në harmoni me vlerat e natyrës.

Vëmendje kryesore gjatë këtyre punimeve duhet të tregohet në dy aspekte

- 1) sistemimi i dherave të krijuar nga këto punime,
- 2) sistemimi i shpateve për të evituar fillimin e erozionit.

Studimi i hollësishëm e strukturave gjeologjike, qëndrueshmërisë së tyre dhe masave të propozuar nga projektuesit e janë garanci që këto probleme mjedisore do të jenë minimale.

Pra, mund të themi se nga ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme.
- Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
- Nuk ka shkarkime në ajër të gazrave apo tymrave.
- Zhurmat në mjediset e punës do të jenë brenda normës shëndetësore të lejuar, dhe për

pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.

- Nuk ka çlirim të aromave të ndryshme etj.
- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës.
- Janë parashikuar marrja e të gjitha masave për mbrojtjen në punë dhe masat për evitimin e rrezikut të zjarrit.

Për këtë aktivitet është e nevojshme që të ketë bashkëpunim me autoritetet vendore dhe grupet e interesit, për ruajtjen e parametrave hidroenergjitike pa prishur ekuilibrat mjedisore dhe ato të nevojave të popullatës për nevoja të ndryshme.

o Trajtimi i vajrave te perdorur

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 765, datë 7.11.2012 "për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura" përfshin të gjitha vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, pajisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje.

Vajrat e përdorura (VP) përfshijnë:

- a) vajrat e përdorura në motorët me djegie të brendshme;
- b) vajrat e përdorura të kutive të shpejtësive (grasot);
- c) vajrat e përdorura lubrifikante minerale;
- d) vajrat e përdorura hidraulike;
- dh) mbetjet vajore nga depozitat;
- e) përzierjet vaj - ujë;
- ë) emulsionet

Gjate ndertimit nuk do te kete ndotje nga vajrat lubrifikante, të lëngshme apo gjysmë të lëngshme, me bazë minerale a sintetike, të cilat janë kthyer në të pavlefshme për qëllimin për të cilin janë prodhuar, pasi janë përdorur nga çdo lloj motori, paisjeje e makinerie që punon me to, si dhe nëse kanë skaduar në magazina apo pika shitjeje. Nuk do te kete derdhje te vajrave te perdorur, të dëmshme në tokë, si dhe shkarkim te pakontrolluar te mbetjeve që rezultojnë nga përpunimi i tyre. Investitori qe ne fillimin e punimeve tregohet i gatshem me masat qe do te marri ne raste se do ndodhi ndonje rast i tille, i derdhjes se vajit te makinerive ne toke.

o Mbetjet inerte

Sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte" Mbetjet inerte me mundesi ricikluese do te grumbullohen dhe do te dorëzohen tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, pra ne kompani ricikluese. Shoqeria investitore, do te ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë mbetjet inerte në në venddepozitimin e përkohshëm sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave. Në vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, do të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3 500 tonë në vit mbetje inerte.

Venddepozitimi i mbetjeve nuk do te behet ne zonat e meposhtme:

- Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;
- Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;
- Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;

- Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me piken e pare.

Mjetet teknologjike qe do transportojne mbetjet do te jene te pajisur me license te tipit III.2.B si detyrim i ligjit nr 10463,date: 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve" i ndryshuar.

o Menaxhimi i mbetjeve nga gomat e perdorura.

Vendim i KM nr. 652, datë 14.9.2016, "Për rregullat dhe kriteret për menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura" nenkupton menaxhimin e mbetjeve nga gomat e përdorura, rregullat dhe kriteret që përfshijnë mbledhjen/grumbullimin, transportimin, ruajtjen/ magazinimin dhe trajtimin e gomave të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit. Në kuptim të këtij vendimi me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

"Grumbullues", personi që kryen grumbullimin e mbetjeve të gomave të përdorura.

"Magazinues", personi që kryen ruajtjen e përkohshme të mbetjeve. "Trajtues", personi që

kryen trajtimin e mbetjeve. Gjate ndertimit, **gomat jashte perdorimit nuk do te**

digjen apo te hidhen por do te grumbullohen dhe transportohen nga shoqeria investitore dhe do te magazinohen ne ambiente te caktuara (shoqeri te licensuara per grumbullimin e tyre) dhe do te trajtohen si goma të përdorura në mënyrë të tillë që të sigurohet mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe e mjedisit perreth ku ndertohet. I gjithë procesi i grumbullimit, transportimit dhe magazinimit do te behet sipas rregullave dhe procedurave te shoqerise se licensuar per grumbullimin e tyre.

o Baterite, akumulatorët dhe mbetjet e tyre

Qellimi i Vendimit te KM, Nr.866, Dt. 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre" është mbrojtja, ruajtja e përmirësimi i cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtja e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative nga bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre. Gjate fazes se ndertimit nuk do te kete probleme dhe ndotje nga baterite dhe akumulatorët e tyre.

o Transferimi i mbetjeve jo te rrezikshme

Vendim i KM, Nr.229, Dt :23.04.2014 "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit". Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet për të gjitha hallkat që ndiqen për transferimin e mbetjeve që nga krijimi deri në destinacionin përfundimtar. Dokumenti i transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme plotësohet dhe nënshkruhet nga krijuesi i mbetjeve, grumbulluesi, transportuesi dhe pritësi që merr në dorëzim mbetjet. Per cdo transferim mbetjesh do mbahet nje dokumentacin sipas shtojces 1 te VKM-se, ne te cilen do te shenohet data perkatese, per llojin e mbetjes, volumet, gjendjen e tyre dhe pozicionin e venddepozitimit, etj.

2.6Informacioni për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative

Punimet ndertimore, mund te zgjasin per nje periudhe 20 mujore te caktuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Puneve Publike, Bashkia Lezhe. Kjo eshte e vlefshme ne kushte teknike, juridike e klime normale, por ne rast se do te hasen veshtiresi gjate punimeve mund te kete edhe kerkese per te shtyrje te afatit te punimeve. Si rrjedhoje edhe ndikimet e fazes ndertimore do te zgjasin per aq kohe sa zgjasin punimet per rehabilitimin. Persa i perket ndikimeve gjate fazes se funksionimit

ato do të jone prezente për atë kohë sa do të përdoret edhe objekti. Këto ndikime nuk janë me rëndësi të vecante, këto janë të krahasueshme me çdo objekt tjetër që ndodhet në zonën e Lezhës. Të gjitha ndikimet e mesipërme nuk janë të përhershme dhe afatgjata, ato janë të perkohshme dhe afatshkurter. Ndikimi në peizazh do të jetë i perkohshëm për fazën e ndërtimit.

- Analizë e përmbledhur e kohëzgjatjes së ndikimeve negative në mjedis

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedis vetëm gjatë fazës së zbatimit të projektit, ku përfshihet ajo parapregatitore e terrenit dhe të ndërtimit të objektit lidhen me veprimtaritë si vijon:

- o Sistemit i sheshit të ndërtimit, gërmimet e tokës dhe demolimet për pastrimin e sheshit;
- o Ndërtimi i magazines e mjedisit zyrtar për mbikqyresit e zbatuesin e punimeve, përcaktimi i vendqendrimit të mjeteve;
- o Hapja e truallit, ndërtimi i themeleve evadimi i dherave;
- o Përcaktimi i rrugëve e koridoreve të qarkullimit në sheshin e ndërtimit.
- o Ndërtimi i objektit.
- o Ndikime të përhershme mjedisore dhe sociale gjatë funksionimit të objektit ku përfshihen edhe aktivitetet e mirëmbajtjes janë:
- o Marrja e përhershme e tokës për ndërtimin e objektit;
- o Ndryshimi në peizazhin urban;
- o Rritja e prezencës së studenteve;

- Analizë për kohëzgjatjen e ndikimeve në biodiversitet

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat artificial urban, shqetesimi i grupeve të kafshëve ose migrimi i perkohshëm i atyre në zonën në afërsi shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe makinerive. Po kështu ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme për të mbështetur biodiversitetin urban. Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i mjaft kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësi të pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

- Analizë për kohëzgjatjen e ndikimeve në ujërat nëntokesore

Ndikimet e mundshme që do të zgjasin vetëm gjatë fazës ndërtimore janë:

- o Punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- o Aktivizimi i makinerive në ndërtim dhe transport, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji.

Ndikimet e mundshme nga ujërat e ndotura dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë të perkohëshme dhe do të zbuten duke aplikuar praktikën më të mirë për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

- Analizë për kohëzgjatjen e ndikimeve mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me fazën parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe të kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; strukturat mbajtëse, themelet, etj), përfshijnë: Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore të cilat janë vlerësuar të jenë të ulët, të një probabiliteti të ulët dhe me shtrirje vetëm lokale.

Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore e nëntokesore, gjatë fazës së operimit.

- Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në tokë

Ndikimi me kohezgjatje pa limit është tjetërsimi i përdorimit të tokës nga punimet e vendosjen e objektit të ri për arsimin universitar. Makineritë e ndërtimit si dhe makineritë e renda që bëjnë germimin e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund ngjeshin ose të dëmtojnë tokën në afërsi të objektit.

Ky ndikim pavarësisht nga kohezgjatja, efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitet të ulët e me shtrirje lokale duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj.

Nuk ka ndikim të prishëm në përdorimin e tokës gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

- Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ajër

Aktivitetet e ndërtimit do të gjenerojë pluhura dhe pezulli me grimca nga punimet e ndërtimit dhe transportit. Aktivitet që gjenerojnë pluhura janë ndërtimet e sektorit të punës, rruge të reja, pastrime e demolime për organizimin e sheshit të ndërtimit, ndërtimi i objektit. Shkarkimet në ajër mund të specifikohen emetime të pluhurave dhe grimcave (pm10). Emetimet me të medha pluhurave mund të ndodhin gjatë oreve të punës në aktivitetet e germimeve e ato ndërtimore. Pluhuri nuk shkakton ndryshime të gjata ose të gjera afatgjata në cilësinë e ajrit lokal, por depozitimi i tyre në objektet e afërta shkakton ndotje dhe për këtë arsye mund të rezultojë në ankesa por që keto ndikime janë të përkohshme, ose gjatë fazës përgatitore dhe asaj të ndërtimit. Ndërsa emetimet me grimcat pezull në atmosferë për një periudhë më të gjatë dhe që mund të transportohen më gjerë sesa pluhuri, nëpërmjet erës, grimca të lëshuara edhe nga motorët të tilla si kompresorë, gjeneratorë, etj. Si madhësia e emisioneve PM10 është relativisht e vogël, çdo efekte anësore që rezultojnë prej tyre ka të ngjarë të jetë relativisht afatshkurtër pa efekte të rëndësishme jashtë kufijve të shesheve të ndërtimit.

Ndërsa gjatë fazës së operimit, ndikimi mund të zbutet duke marrë masat e duhura, të ngjashme me fazën e ndërtimit.

- Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, vinça, etj.

Reagimi i njerëzve për të vibracioneve në terren është e ndikuar nga shumë faktorë fizike ku përfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Për shkak të faktit se ka prona banimi në afërsi të objektit, ka gjasa që vibrimet nga ndërtimi i objektit të propozuar të jetë të evidentueshme.

- Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme në peizazh dhe vizualiteti.

Ndikimi në peizazhin urban të zonës është i dukshëm por duke patur parasysh se objekti është shtuar krahas objekteve të tjera si dhe shërbimeve ekzistuese, perceptimi në ndryshim peizazhi është jo shumë potencial dhe i ambientueshëm me pamjen. Si përfundim perceptimi veçanërisht në distancë do të jetë i moderuar për faktin se kemi të bëjmë me zhvillim të objekteve të reja që ruan vijën ndërtimore të atyre ekzistuese.

- Analize për kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga gjenerimi i mbetjeve

Në fazën ndërtimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qenë se shumica e aktiviteteve të ndërtimit rezultojnë me mbetje të kufizuara e jo të rëndësishme, sidomos nga përdorimi i elementeve ndërtimore të parafabrikuar.

Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit.

Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat nga amvisëritë.

Gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së objektit, prodhimi i mbetjeve të natyrës urbane është normalisht i administrueshëm pasi do të shërbehet me pikat me konteniere në lagje për banoret si dhe aktivitetet e shërbimeve.

2.7 Shtrirja hapësinore e ndikimit negativ në mjedisin e zonës

- Distancën fizike nga vendndodhja e projektit

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit në mjedis mund të shtrihet vetëm në një zonë periferike të kufizuar nga objekte e tjera ndertimore si pallate, por përgjithësisht nuk mund të jetë jashtë hapësirës së territorit ku shtrihet ndërtimi i objektit veçanërisht gjatë fazës së operimit. Ndërsa të vetmet burime të vibrimit që merret në konsideratë do të jenë kamionë të rëndë gjatë udhëtimit për në objekt. Për aktivitetet e ndërtimit distance nga ku mund të perceptohet vibrimi është si vijon: Punimet gërmuese të tokës deri 10 -15 m largësi. Kompaktimi dhe ngjeshja me vibrim 10 – 15 m largësi. Levizja e kamioneve të rëndë, 5 deri 10 m.

- Vlerat e ndikuara

o Biodiversiteti

Duke qënë se vendi ku do të ndërtohet objekti është sipërfaqe truall në një zonë të zhvilluar urbane nga të gjitha anët, në përgjithësi karakterizohet me vlera të uleta për sa i përket biodiversitetit. Në kushtet e habitateve artificiale urbane dhe mungesë të specieve endemike, të rralla ose të rrezikuara ndikimi është i papërfillshëm.

o Fauna

Ndikimi në faunë është i ulët e jo i rëndësishëm, pasi nuk përfshijnë një numër të madh të organizmave, që ndodhen në popullata të rregullata e të qëndrueshme osë që janë veçanërisht të ndjeshëm, të paaftë për të kompensuar humbjet në mënyrë të arsyeshme, ose janë tashmë të ulët në numër.

o Shpendet

Ndikimi mbi zogjtë gjatë ndërtimit mund të vlerësohet si i moderuar dhe i kthyeshëm. Jovetebrore, amfibet dhe zvarraniket, Dëmtimi e eliminimi nga automjetet përbën një efekt të mundshëm gjatë ndërtimit, që ndikon në shkatërrimin të drejtpërdrejtë të individëve rastësore, si dhe faunës jovetebrore. Rëndësia e ndikimeve të mësipërme mund të vlerësohet e ulët dhe e papërfillshme.

o Ujra nëntokesore

Nese nuk merren masa, ndikimet e mundshme në cilësinë e ujërave nëntokësore janë vlerësuar të moderuar me probabilitet të ulët, të madhësisë së ulët. Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e ndotura dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.

o Ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore janë vlerësuar të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

o Ndikimet në tokë

Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar e probabilitet të ulët duke mos marrëparasysh tjetërsimin e përdormit të saj si dhe me shtrirje locale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin racional të rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara. Pasi janë zbatuar masat e duhura zbutëse, ndikimi i përgjithshëm mbi cilësinë e tokës mund të vlerësohen të një rëndësie të papërfillshme si dhe në masë të vogël.

o Ndikimi në ajër

Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshem, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale

o Ndikimi nga zhurmat

Zhurma gjenerohet kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si fadromat, kamionet, etj, për të cilat ka matje të caktuara të nivelit të zhurmës së tyre.

Ligji Shqiptar Nr 9774, i 12.7.2007; "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis" - neni 10, parashikon që masat për mbrojtjen nga zhurma të zbatohen në varësi të kohës kur zhurmat janë të krijuar. Kufijtë për nivelet e pranueshme të zhurmës në zonat e banuara, janë specifikuar në Rregulloren e përbashkët të MMPAU dhe MSH, Nr.8, të 27.11.2007 "Mbi përcaktimin e kufijve për zhurmave në mjedise të caktuara". Nuk ka asnjë ndikim negativ të parashikuar për banorët përreth nga zhurma e gjeneruar nga objekti gjatë fazës operacionale. Ndikimi negativ në kafshët e egra ka gjasa të jetë i papërfillshëm.

o Ndikimi nga vibrimet

Vibrimet gjenerohen kryesisht gjatë aktivitetit të ndërtimit. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm perceptueshme. Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogla dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.

o Ndikimet në peizazh dhe vizualitet.

Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitete të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të objektit si element zhvillimor urban më objektet e tjera të ngjashme ekzistuese. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

o Ndikimi në komunitet, Shëndeti dhe Siguria.

Nëse zbatohen masat e duhura, ndikimi i përgjithshëm mund të vlerësohen të një rëndësie të ulët.

o Gjenerimi i mbetjeve

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme rehabilitimit janë marrë.

2.8 Rehabilitimi i mjedisit të ndikuar dhe mundësia e kthimit të tij në gjendjen e mëparshme

- Mundësia e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme

Rehabilitimi mjedisit të ndikuar është akti i restaurimit të mjedisit për ta kthyer atë në gjendjen origjinale, para ndikimeve ne këtë rast nga zbatimi i projektit. Nëpërmjet rehabilitimit synohet mbrojtja e cilësive natyrore të trashëguara të mjedisit, mbrojtja e shendetit të punonjësve, mbrojtja e cilësisë së ujerave nëntokesore e sipërfaqësore, mbrojtja së cilësisë së tokës, ajrit, garantimi i një zhvillimi të qëndrueshëm ne harmoni me mjedisin. Kthimi i mjedisit në gjendje të mëparshme është një proces që përfshin zbatim masash e veprimesh që bëjnë përgatitjen e sistemitin e terrenit të ndikuar, për parandalimin e erozionit, të ngjeshjes se metejshme te tokes, për gjelbërimin e rigjelbërimin, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në mënyrë të vazhdueshme që garanton shendetin e mjedisit.

Masat rehabilituese të përcaktuara në planin të rehabilitimit zbatohen duke kryer punime që adresojnë kërkesat teknike si dhe ato estetike e ekologjike.

Sistemi i sheshi të ndertimit të objektit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike tëketij objekti, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngushte me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqeve te sheshit midis elementeve ndertimore të objektit, korridoret qarkulluese te sherbimeve te mirembajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike jashtë sheshit është sipërfaqe e zhvilluar urbane me objekte banimi, rruge e trotuare dhe duhet të restaurohen në rastin e ndikimeve të paevitueshme duke ju referuar praktikave më mira restauruese e rehabilituese në tëresi që risjellin e promovojnë vlerat e peizazhit si dhe cilësitë e kësaj zone urbane. Në këtë mënyrë ndikohen në rritje të cilësisë mjedisore urbane dhe në përmirësimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen nga erozioni etj.

Mundesimi i gjelberimit ne objekt nga projekti më të gjitha menytrat që lejon një mjedis i tillë urban duhet të bëhet për të plotësim sa më maksimalisht kërkesat përmirësuese e restauruese estetike dhe ekologjike.

Llojet bimor që përdoren për rritjen e vlerave estetike mjedisore urbane janë në varesi të volumit të kurores vegjetative të llojit, anës dekorative që prezanton, si dhe dendësise së përdorimit të llojit.

o Sistemimi i terrenit të ndikuar dhe përgatitja e vendit.

Nderhyrja e parë që behet për rehabilitimin e vendit është sistemimi i tij, dhe sigurimi e ruajtja e vendit nga mosdëmtimi, gjatë punimeve rehabilituese.

o Masat e sugjeruara

Punimet e pastrimit e sistemit të vendit pas përfundimit të ndertimit të objektit ndertimor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë sherbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në objekt.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga territori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Ndalimi i çdo veprimtarive që ka të beje më direkt ose indirekt me aktivitet ndertimor.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës.

Përdorimi i bimësisë si pjesë e projektit është ndikimi më potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar urban me funksion të shumfishtë ripertrites dhe me ndikime direkte në permiresimin e treguesve mjedisor. Ndikim të rëndësishëm ka në permiresimin e vlerave peizazhiste, duke përmirsuar aspektin pamor.

o Masat e sugjeruara

- Përdorimi i bimeve dekorative që të përshtatet me kerkesat estetike dhe që garanton suksesin e përmirsimit të peizazhit urban.
- Përdorimi i nje shtrese me matërial të tillë që të ndaloje mbirjen e barerave të këqija rreth fidaneve, ruajtjen e për ruajtjen e lageshtirës.

▪ **Mbjellja e fidaneve**

Mbjellja behet me anë të fidaneve të prodhuar ne fidanishte të llojeve dekorative. Skemat e mbjelljes të llojeve behen duke respektuar dendesinë e lejuar si dhe kombinimet e llojeve.

▪ **Mirëmbajtja**

Punimet për mirëmbajtjen lidhen me sherbimet që kërkojnë rritja e bimesisë për plotësimin e kërkesave për ujë, elemente ushqyes, krasitje, pastrim etj. Në mënyrë të veçantë do të bëhet menjëherë zevendesimi i fidaneve që rezultojnë të deshtuara në mbirje ose që zhvillohen të dobët në krahasim me pjesën tjetër.

▪ **Monitorimi**

Monitorimi lidhet me të gjithë aspektet e mbarvajtjes së nderhyrjeve rehabilituese për të garantuar suksesin e saj. Inspektimet e vazhdueshëm në lidhje me zenien e fidaneve e të gjendjes së vegjetacionin në tëresi do të sherbejnë për marrjen e masave të menjëhershme të vijshmërisë së sukseseshme të rehabilitimit.

- Kostot financiare të përafërta për rehabilitimin

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit janë të paraqitura në tabelen në vijim ku janë parashtruar edhe kostot e përafërta financiare. Masat e identifikuar ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tëresi ku kostot e vleresuara përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

Veprimtaria	Efektet potenciale	Plani i minimizimit e zbutjes së ndikimit	Pergjegjesia	Kosto e përafërta në Euro
Pastrimi e pergatitja e vendit ku zbatohet projekti	Ngjeshje dhe demtimi i strukturese se tokes se zones ne afersi	Rrethimi i sheshit te ndertimit. Ndalimi i nderhyrjeve te panevojshme ne afersi. Krijimi isektorit te punimeve brenda sheshit dhe spostimet e nevojshme sipas kerkesave teknike e zhvillimore te objektit.	Zhvilluesi	10 000 (pa elementet e sektorit)
		Vendosja e tabelave sinjalizuese		1000

Sistemimi i vendit te punes	Presioni ne sistemin drenazhues dhe erozionin e tokes	Hartimi dhe zbatimi i nje plani drenazhimi per mbrojtjen e tokes nga erozioni dhe evitimi i peggjeve me uje.	Zhvilluesi	3000
Hapjet e themeleve	Emetime ndotese ne ajer	Levizja dhe evadimet e dherave te behen ne kushtet e lagies per uljen e pluhurit. Sperkatja e vazhdueshme e stoqeve, mbajtja e mjedisit paster.	Zhvilluesi	2000
Punimet e ndertimit	Ndikimi me zhurmat e vibrimet	Pajisjet e ndertimit duhet te jene sipas Direktivave Standarteve te Komunitetit European 2000/14/EC, Maj. 2000. Kjo direktive aplikohet tek prodhuesit e pajisjeve qe gjenerojne zhurma. Te gjitha pajisjet duhet te mbahen ne kushte te mira.	Zhvilluesi	Te vogla
Largimi i mbetjeve nga pastrimi i terrenit	Ndotja e ajrit, Ndikim ne ndotjen e tokes Ndikimi ne shendetin e punonjesve	Caktimi, i vendit te administrimit e trajtimit te mbetjeve. Marrja e lejeve nga Njesia e Qeverisjes lokale per vendosjen e dherave. Sigurimi i paisjeve personale mbrojtese nga pluhurat. Evitimi i shpejtesive te panevojshme te automjeteve	Zhvilluesi	2000
Punimet operatore ne objekt	Mungesa e vegjetacionit	Hartimi i nje projekti per gjelberimet e mundshme. Mirembajtja	Studio projektuese Zhvilluesi	3000
Punime operatore	Rreziku i demtimit te infrastruktures urbane	Mirëmbajtja e riparimi i menjehereshme sipas rastit.	Zhvilluesi	1000 (gjate ndertimit).

Prodhimi i mbetjeve të rrezikshme si dhe ujerave të zeza gjatë operimit e funksionimit	Ndotja e tokës, e ujerave sipërfaqesore e nentokesore	Hartimi i planit të menaxhimit të mbetjeve. Lejet, për lidhjen me rrjetin urban të kanalizimeve, ujësjelles etj. Marrveshjet e kontratat me subjektet sipas rastit.	☐ Zhvilluesi ☐ Subjektet që kryejnë shërbimet	2000 (nga zhvilluesi gjatë ndertimit)
--	---	---	--	---------------------------------------

2.9 Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis

Ne mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që duhet të zbatohen nga investitori ose nënkontratuesit për zbatimin e projektit. Në planin e organizimit të punës, shoqëria do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndikuar sa më pak në mjedisin rrethues.

Masat kryesore që do të ndërmerren nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Bashkia Lezhë në drejtim të mbrojtjes së mjedisit janë:

○ Rrethimi i objektit me sinjalistiken perkatese

Menjëherë do të kryhet rrethimi i objektit me sinjalistiken perkatese, për të shmangur daljen e cdo lloji mbeturine jashtë territorit dhe në të njëjtën kohë për të shmangur cdo lloj hyrje e marrje kontakti me objektin ku do të kryhen punimet.

○ Evadimi i dherave e mbetjeve të tjera të ndertimit

Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Bashkia Lezhë, me shpenzimet e veta do të kryejë evadimin e dherave dhe mbetjeve të tjera të ndertimit që do të dalin nga prishja e objektit ekzistues si edhe gjatë hapjes së gropës së themeleve. Grumbullimi dhe transportimi i dherave do të bëhet konform kërkesave dhe rregullave mjedisore. Ato do të evadohen brenda ditës, për të mos penguar punimet e metejshme e për të mos ndotur mjedisin. Të gjitha mbetjet do të largohen sipas VKM Nr.99, datë 18.02.2005.

Referuar VKM Nr.99, datë 18.02.2005 Për miratimin e katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve", mbetjet që prodhohen klasifikohen me kodet:

20 01 01 Leter dhe karton,

20 01 02 Qelq

20 01 39 Plastikë

20 01 40 Metalet,

20 02 02 Dhera dhe gure

○ Evadimi në mënyrë të vazhdueshme i të gjitha mbeturinave që do të krijohen gjatë punës Mbeturinat e ngurta, me natyrë dhe perberje, do të jenë mbeturina inerte të tilla si gure, leter, qelq, mbeturina llaci e betoni etj. Për grumbullimin e mbeturinave do të mbahen konteniene të vecante dhe me vone do të evadohen brenda ditës për të mos penguar punimet e metejshme e ndotur mjedisin. Do të merren masa për lagjen e mbeturinave.

○ Evadimi në mënyrë të vazhdueshme dhe depozitimi i mbeturinave urbane

Evadimi ne menyre te vazhdueshme dhe depozitimi i mbeturinave urbane, qe do te kryhen gjate veprimtarise se ndertimit, dhe pas venies ne funksion te saj, do te kryhet ne vendin dhe ne kohen e caktuar qe do te miratohet dhe konfirmohet nga Bashkia Lezhe.

o Evadimi i mbeturinave urbane

Evadimi i mbeturinave urbane te krijuara nga aktiviteti I prishjes se objektit ekzistues si edhe pas perfundimit te objektit, do te kryhet ne kohen dhe vendin e caktuar, konform kerkesave te vendosura nga Bashkia Lezhe. Nuk do te krijohen ndotje nga mbeturinat urbane per vete faktin se do te realizohet vendosja e konteniereve metalike per godinen.

Largimi i tyre eshte pjese e procesit te punes qe kryhet aktualisht nga kompania private e pastrimit qe merret me grumbullimin, evadimin dhe transportimin e mbeturinave urbane per ne vendin e caktuar nga Bashkia Lezhe per kete qellim. Keto konteniere do te evadohen rregullisht sipas mareveshjes qe firma e pastrimit ka kontraktuar me Bashkine Lezhe.

o Rrjeti i kanalizimeve dhe i ujit te pijshem

Projekti ka parashikuar lidhjen me rrjetin ekzistues per te bere te mundur furnizimin me uje.

o Rrjeti i kanalizimeve te ujrave te zeza

Ndersa per kanalizimet jane parashikuar te shkarkohen ne rrjetin ekzistues te shkarkimeve, gjithashtu edhe kjo e parashikuar ne projekt.

o Ndikimi visual

Bazuar ne pozicionin e objektit qe do te ndertohet mund te thuhet se impakti vizual mund te jete maksimal.

o Ndotja e ajrit

Ndotje te ajrit do te kemi gjate procesit te ndertimit si rezultat i ngritjes se pluhrave nga levizja e mjeteve te transportit. Me rehabilitimin e zones keto pluhura bien si rezultat i perdorimit te ujit, ngelet vetem imitimi i gazit ne atmosfere si rezultat i levizes se mjeteve te transportit. Ne termat e ndikimeve ne shendet, ndotesit kryesore jane: NO₂ dhe PM₁₀. NO_x mund te kontribuojne ne depozitim rajonal te acidit por ai eshte ne vlere te ulte. Ju shtohen ketyre ndotesve dhe gazrat e cliruara nga motoret e automjeteve qe leshojne dioksid karboni (CO₂) dhe nje perberje te pakte te oksideve te azotit si N₂ O₂.

Masat zbutëse për ndikimin në ajër

- Spërkatjen e rregullt me ujë të zonës së punimeve pas çdo procesi pune dhe rrugëve të transportit, për mbajtjen nën kontroll të pluhurformimit dhe ngritjes së tij gjatë transportit të materialeve të ndërtimit. Forcimin e zbatimit të këtyre masave edhe më shumë në kohën e thatë dhe me erë,
- Përdorimin e automjeteve të mbuluara (të mbyllura ose të mbuluara me mbulesë të posaçme) për transportin e materialeve'
- Zbatimi i kufijve të shpejtësisë në zonat nën ndërtim për të ulur sasinë e pluhurit që mund të ngrihet gjatë qarkullimit të tyre,
- Lënda djegëse që do të përdoret nga mjetet e punës, të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit specifik për cilësinë e lëndëve djegëse.,
- Të mos mbahen automjetet dhe mjetet e ndërtimit ndezur gjatë kohës kur nuk janë në punë,
- Të mirëmbahen dhe ndryshohen në kohën e duhur filtrat e motorëve të mjeteve të transportit e të ndërtimit.
- **Kontraktori duhet të zbatojë nivelet kufi të shkarkimeve në ajër, referuar Ligjit Nr. 162/2014 "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis" dhe VKM Nr. 248, datë:**

24.03.2003 "Për Miratimin e Normave të Përkohshme të Shkarkimeve në Ajër dhe Zbatimin e tyre".

O Zhurmat

Burimet dominante të zhurmës së makinave janë zakonisht gomat dhe marmitat. Burimet e tjera të rëndësishme të zhurmës janë motoret dhe marshet/kutite e shpejtesisë. Nivelet aktuale të zhurmës në rrugën do të ndryshojnë me kushtet e trafikut dhe me crregullimin e makines. Njesia e zakonshme për të matur zhurmen është decibel (dB). Decibelet paraqiten në një shkallë në të cilën një dopio-degjim i nivelit të zhurmës korrespondon me një rritje prej rreth 10 decibele. Një numër faktoresh influencojnë se sa efekt do të ketë një tingull në receptorin e prekur fuqishëm. Këto përfaqësojnë:

- Dispersionin gjeometrik: mëqenëse njëri merr me shumë nga një burim tingulli, forca e tingullit nga burimi përhapet në një zonë më të madhe dhe më të madhe. Vlera në të cilën ndodh kjo është afërsisht 3 dB për dyfishimin e distancës për çdo burim të madh tingulli si rrugët.
- Pengimi në rrugën e përhapjes nga burimi i zhurmës tek marresi si p.sh. një ndërtesë e mëdhe ose tipare topologjike. Shkalla e lehtësimit varen në gjeometrinë e pengimit dhe në karakteristikat e frekuencës së burimit të tingullit.
- Tipi i tokës mbi të cilën po kalon tingulli mund të ketë një influencë të konsiderueshme në nivelin e zhurmës tek marresi p.sh.: mbjelljet, pemët, etj krahasuar me sipërfaqet e forta.
- Karakteristikat meteorologjike si shpejtësia e erës dhe drejtimi mund të ndikojnë nivelet e zhurmës.
- Nivelet e zhurmës së ambientit dhe mjedisit. Gjate këtij studimi nuk janë bërë matje për zhurmen e mjedisit. Nuk ka matje precize të disponueshme për rrugën në fjalë por nuk është parashikuar të ketë ndonjë vend ku niveli i zhurmës do të afrohet atyre që paraqesin një bezdi të ndjeshme tek banorët lokalë, ose që do të paraqesin lloje kercënimesh për shëndetin.

Masat zbutëse të propozuara për zhurmat, vibrimet dhe trafikun

- Të kontrollohen kushtet teknike të mjeteve të punës në mënyrë periodike për të evituar, parandaluar rrjedhjet e lubrifikantëve e të hidrokarbureve në mjedis, emetimin e gazeve të shkaktuara nga avari teknike të mjeteve.
- Përdorimi i makinerive dhe pajisjeve eficiente, të reja dhe me silenciator.
- Fikje e motoreve në rastin e pushimeve.
- Kufizim i përdorimit të motoreve me numër të lartë xhirosh.
- Ulje e shpejtesisë së automjeteve në rrugë.
- Zbatimi i rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesve të mjeteve.
- Shfrytëzim maksimal i rrjetit rrugor ekzistues.
- Të vendoset sinjalistika paralajmëruese pranë sheshit të ndërtimit.

Kontraktori është i detyruar të marrë masa për minimizimin e zhurmave në përputhje me Ligjin nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", Udhezimit Nr.8 datë 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

O Emetimet e ndotjeve nga transporti
Zbatimi i sistemeve të shuarjes së pluhurit:

- Ujitja e anesoreve te rrugeve, perdorimi i mjeteve ruajtese per te kufizuar emetimet e pluhurit (per shembull: perdorimi i mekanizmave/karuselve lares ne cdo zone magazine, te cilat mbahet perdite);
- Kufizimi i shpejtesise se mjeteve ne rruge. Ne menyre qe te mbahet/ruhet cilesia e ajrit dhe te shmanget shkaktimi i ndonje ngaterrese tek banoret lokale, eshte e keshillueshme qe stabilizimi i tokes/baltes (gelqere e pashuar, kordonet hidraulike) duhet te behet vetem:
- Gjate periudhave me ere te ulet;
- Ne zonen e ekstradimit/prejardhjes;
- Ne sektoret e vecante ne mes zonave ku nuk ka mbjellje te ndjeshme, ne menyre qe te perfshihet ne menyre te natyrshme pluhuri ajror. Reduktimi i ndikimeve te ndertimit perfshin gjithashtu:
- Linjat e transportit te perdorura per shperndarjen e materialeve.
- o Vleresimi mjedisor

Vleresimi mjedisor i territorit te marre ne studim perqendrohet ne:

- a. Evidentimin e elementeve me rendesi te vecante per ruajtje.
- b. Vleresimi i burimeve si nga aktivitetet antropogene, si ndertimet banesat, ndertesat ekonomike, tregtare, arsimore, ndertimet infrastrukture si dhe punimet inxhinierike me permasa te medha ne territor.

Duke patur parasysh karakterin e studimit ne nivel projekti vleresimi mjedisor nuk hyn ne thellesi te elementeve dhe thellim te elementeve ekologjike, per te cilat do te kerkohen studime te vecanta ekologjiko-mjedisore. Parametrat dhe interpretimet mbeten ne kufij te interesave urbane te planifikimit me tendencen per gjetjen e nje zhvillimi te qendrueshem urban ne raport me mjedisin.

- o Ndikimet ne toke dhe erozioni

Kjo zone nuk ka predispozim te theksuar per erozion.

- o Disa ndikime ne toke

Gjate shfrytezimit nuk pritet te kete ndryshime ne topografine lokale. Ne projekt parashikohet nje radhe dhe drejtim i tille shfrytezimi, qe ne kombinim me masat e tjera suplementare si te mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojne erozionin.

Ndikimet e emetimeve kimike dhe depozitimeve ne toke dhe rrethina. Aktiviteti parashikon vetem ndertimin.

Ne procesin e ndertimit nuk ka derdhje apo shkarkime te ngurta ose te gazta ne ambient te elementeve kimik ose te tjere element te demshem per mjedisin.

- o Ndikimet ne perdorimin e tokes dhe te burimeve ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore
- Siperfaqja qe do ti nenshtrohet shfrytezimit, nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore.

- o Ndikimet ne modelin drenazhues te zones

Do ti behet drenazhim zones me shtrese zhavorri dhe me tubacione betoni.

- o Ndikimet ne ujerat nentokesore

Nuk do te kete ndotje nga lende helmuese, te rrezikshme (karburante) (si ne rastin e ujerave siperfaqesore). Ndonese ndikimi do te jete i vogel ai do te merret ne konsiderate gjate procesit te rehabilitimit.

Masat zbutëse të propozuara për token dhe dherat

- Rrethimi i zonës ku do të kryhen punimet, për të shmangur hyrjet e pa autorizuar.
- Punimet do të kryhen vetëm në gjurmën e projektit.

- Kompania të ndjek me përpikmëri projektin teknik për të evituar erozionin e tokës, me qëllim ruajtjen e cilësisë së ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore.
- Mbetjet e rrezikshme (vajra, karburante, bojra, solvent etj.)duhet te mbahen ne vende te vecanta.
- Riperdorimi i materialit të gërmuar për mbushjen dhe nivelimin e sipërfaqes së kantierit të ndertimit.
- Te mbrohet rrjeti i furnizimit dhe shpërnarjes së ujit.
- Të bëhet pastrimi i mjeteve të punës para daljes nga kantieri për të mos shkaktuar ndotje në mjedis.

Masat zbutëse për ndikimin në ujëra

- Te evitohet në maksimum rrjedhja e vajrave nga automjetet dhe mjetet e ndertimit;
- Te parashikohen mjete dhe mundësi për mbledhjen e vajrave në rast derdhjeve aksidentale në tokë;
- Bitumi, bojrat dhe lëndet e tjera toksike të përdoren me kujdes, për të mos ndotur tokën dhe ujërat;
- Enët ku do të mund të depozitohet uji për nevojat e kantierit, të vendosen në vend ku mundësia e rrjedhjes së lirë të ujit, në rast derdhjeve aksidentale, të jetë minimale;
- Furnizimi me ujë të pijshëm të bëhet në tubacionin kryesor, me miratimin të organeve kompetente.

Masat zbutëse të propozuara për mbetjet

- Të mos hidhet asnjë mbetje e ngurtë ose e lëngët në mjedisin ujor dhe atë tokësor.
- Mbetjet të grumbullohen të ndara sipas kategorive dhe të menaxhohen nepermjet subjekteve të ndryshme të licensuar për riciklimin e tyre, si p.sh. metalet, druri, plastika, qelqi, mbetjet organike, plastika, etj.
- Riperdorimi i materialit të gërmuar për mbushjen dhe nivelimin e sipërfaqes së kantierit të ndertimit.
- Subjekti të kujdeset për menaxhimin e mbetjeve të krijuara nga veprimtaria, ato të ambalazhimit dhe ndërtimit, duke i transportuar në mënyrë të rregullt në vend grumbullimit të caktuar nga Njësia Vendore. **Zotëruesit e mbetjeve inerte duhet të zbatojnë detyrimet që janë të përcaktuara në VKM nr.575, datë 24.06.2015 “Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte”.**

Per menaxhimin e mbetjeve kontraktori është i detyruar:

1. T’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në landfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”
2. T’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për

licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

3. Të nënshkruajë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme"

4. Te pergjigjet për dëmet e drejtpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.

Depozitim i mbetjeve do të bëhet në përputhje me VKM Nr.575, date 24.06.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".

Në rast se do të gjenerohen mbetje të rrezikshme të jepet informacion rreth llojit të tyre si dhe të dorëzohen sipas kërkesave të VKM-së nr.371, datë 11.06.2014 "Për përcaktimin e rregullave për dorezimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorezimit të mbetjeve të rrezikshme".

Mjedisi human

- Të vendoset sinjalistika paralajmëruese përgjatë gjithë segmentit të punimeve me qëllim shmangien e aksidenteve njerëzore. Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik .
- Trainim i punetoreve dhe stafit të ndermarrjes mbi sigurinë në punë .
- Mbajtja në gatishmeri e nje kendit te ndihmes se shpejte.
- Mbajtja e detyruar e kaskes dhe mjeteve te tjera te duhura, sipas vendit dhe procesit te punes.
- Ndermarrjet e kontraktuara per ndertimin e objektit ti kene te gjithe punonjesit te siguar, duke shmangur plotesisht punen ne te zeze.
- Rekomandime për Zbutjen e Ndikimeve në Mjedis

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave të dhëna në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Punime me mbrojtje brenda kantierit, lagia e tokës. Në asnjë rast të mos çënohen territoret kufitare.
Fauna	
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Drejtuuesi Teknik i Punimeve ka për detyrë shpërnguljen e çdo specie që jeton brenda zonës së projektit si edhe trajtimin e tyre tek veterineri në rast aksidentesh.
Cilësia e ajrit	

Rritje e emetimeve të CO ₂ , SO ₂ , NO _x , PM, HC (VOC) nga djegia e karburantit të automjeteve lëvizëse	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë këmbimi rezerve brënda kantierit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i kantierit dhe mjeteve të punës.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit	Rehabilitim, sistemim dhe disiplinim i sitemit të kullimit (drenazhimi i ujrave sipërfaqësore)
Mbetjet	
Shtimi i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në kantier dhe nga operacionet për restaurimin dhe hidoizolimimin e tarracës	Vënd grumbullim i diferencuar. Riciklim Transporti në vendepozitimin e caktuar nga Njësia Administrative Vendore. Menaxhim i mbetjeve inerte sipas VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
Ujërat e Ndotura Urbane	Lidhja me kolektorin kryesor të kanalizimeve të zonës
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

A. PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

Masa te Pergjithshme

Plani i menxhimit te mjedisit (PMM) paraqet nje set lehtesimesh, masa monitoruese dhe institucionale te cilat do te adoptohen gjate fazes se ndertimit dhe asaj operacionale per te eliminuar apo per te zvogluar ndikime te pafavorshme mjedisore apo sociale te cilat mund te dalin nga punimet e ndertimit per **"RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESE, SHTESE ANESORE 3 KAT DHE NDERTIMI I PALESTRES NE SHKOLLEN 9-VJEÇARE "MARASH GJONI" NJESIA ADMINISTRATIVE RRILE, BASHKIA LEZHE"**, kryesisht konsiston ne komponentet qe vijojne:

- o Masat mjedisore lehtesuese, jane nje seri masash specifike te zhvilluara ne baze te te kuptuarit te ndikimeve qe do te kete ne te ardhmen ne ndertimi dhe operimi e rruges. Masat lehtesuese jane hartuar per te lehtesuar keto ndikime negative potenciale dhe qe ti zvogloje ato deri ne nivele te pranueshme ashtu sic mund te percaktohen nga standartet e aplikuar, kur eshte e pershtatshme.

- o Plani monitorues mjedisor, do te jete shume i rendesishem per mbikqyrjen dhe menaxhimin e mjedisit dhe do te mbahet periodikisht per te monitoruar komponentet specifike dhe per te siguruar te dhena te cilat tregojne vleren e nivelit ndikues.
- o Rregullime institucionale, per te perfunduar perkufizimin e pergjegjesive per zbatimin dhe monitorimin e masave lehtesuese ashtu sic jane percaktuar.

o *Monitorimi i parametrave mjedisore*

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e Ajrit	PM10, PM2.5 SO2, NOx, CO , CO2 ,HC	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 4 jave	Eksperti Mjedisor
2	Emetimi i zhurmave	Niveli i zhurmave në dB	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 4 jave	Eksperti Mjedisor
3	Monitorimi i shpejtësisë maksimale të valës zanore (PPV)		Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 4 jave	Eksperti Mjedisor
4	Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 1 jave	Oficeri i Sigurisë
5	Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit	Regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 8 jave	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Punimeve
6	Dëmtim i vegjetacionit apo të mbjellave	Regjistrohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 4 jave	Eksperti i Mjedisit

7	Monitorim i zbatimit të kushteve të Raportit të VNM-së	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i projektit deri në përfundimin e tij	Çdo 4 jave	Eksperti i Mjedisit & Inspektoriati përkatës
---	--	---------------------------------------	---	------------	--

2.10 Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë)

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim të mjedisit ndërkufitar. Projekti nuk ndikon në cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin ndërkufitar. Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

3. KONKLUZIONE DHE PERFUNDIME

Për nderhyrjet e nevojshme në rrjet me qëllim dhe përmirësimin e tij, aty ku është e nevojshme, do të bashkëpunohet me institucionet përkatëse.

1. Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbërta në hapësirën ku është parashikuar ndërtimi është një tjetër faktor për mbrojtjen e mjedisit.
2. Mjetet e transportit do të pastrohen herë pas here për të minimizuar ndotjen nga pluhurat që mund të shkaktojnë gjatë transportimit të materialeve në rrugët automobilistike të qytetit.
3. Gjatë funksionimit të objektit **"RIKONSTRUKSION I GODINES EKZISTUESË, SHITESË ANESORË 3 KAT DHE NDËRTIMI I PALESTRES NË SHKOLLËN 9-VJECARE "MARASH GJONI" NJESIA ADMINISTRATIVE RRILË, BASHKIA LEZHE"**, do të jenë marrë të gjitha masat për minimizimin apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.

Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti, veprimtaritë që do të japin ndikime të mundshme negative në mjedis gjatë të gjitha fazave të këtij procesi, asaj parapregatitore, të ndërtimit të objektit e të venies në funksion janë veprimtaritë ndërtimore të cilat mund të ndikojnë në mjedisin biofizik dhe social – ekonomik. Për këto ndikime ky raport i VNM-së ka specifikuar masa konkrete zbutëse të ndikimeve. Në këtë raport janë parashtruar gjithashtu në mënyrë të detajuar dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes. Nga vlerësimi i ndikimit në mjedis të ndërtimit të objektit arrihet në këto përfundime:

- o Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit rezultojnë të një rëndësie pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese. Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.
- o Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme, në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonën e projektit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e ndotura dhe mbeturinat e ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të

- ulët me shtrirje lokale. Ato mund të zbuten duke zbatuar praktikat e duhura për këto lloje të mbetjeve. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.
- o Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e ndotura dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.
 - o Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara.
 - o Per tektoniken dhe sizmicitetin, do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndërtimit të komponentëve të projektit të propozuar.
 - o Aktivitetet e projektit duhet të marrë në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventual negativ të tilla si lëngëzimi e tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime vlerësohet me probabilitet të ulët, me madhësi e shtrirjen lokale. Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Me marrjen e masave zbutëse përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme
 - o Ndikimi, i aktiviteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të objektit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm të parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale.
 - o Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ata janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogël dhe mund të zbuten me marrjen e masave të pershtatshme të propozuara.
 - o Gjatë fazës parapergatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitet të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të vepres ngjitur me nenstacionin ekzistues. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.

EKSPERT MJEDISI**Sidita Kalaci**

Çertifikuar sipas Vendimit Nr.122, datë 17.02.2011
me nr. 414 date 23.06.2017